

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7691 E shtunë 27 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Marrëdhënia mes SHBA dhe Rusisë përfshin brenda saj edhe dialogun, gjeopolitikën dhe përplasjen e interesave mes tyre. Kjo cilësi e marrëdhënies ...
Vijon në faqet 20-21

Nga VASIL KURETA

Dialog, gjeopolitikë dhe përplasje interesash SHBA-Rusi



Opinion **i** Ditës

Të enjten në "Opinion", Vangjush Dako u përpoq të luajë rolin e shejtan budallait. Kur e pyesnin se si kishte mundësi që ishte përgjuar duke folur ...
Vijon në faqet 21

Nga ANDI BUSHATI

Kush e beson sot Vangjush Dakon?



“Vol-Vo 4”/ Zbardhen përgjimet e policëve
Basha: Arrestoni Dakon. Kryetari i bashkisë: Bashkë do shihemi në gjyq

Vangjush Dako flet me grupin e Shijakut, mister mbi hetimet e prokurorisë. Berisha akuzon Ndreun
VALENTINA MADANI
Për demokratët, përgjimet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda ndaj kryebashkiakut të Durrësit janë provë e mjaftueshme që Vangjush Dako të merrret i pandehur nga organi i akuzës. Vetë Lulzim Basha kërkon ...
Ne faqet 2-3

BUXHETI I VITIT 2019, ISH-PRONAREVE DO T'U NDAHEN 5 MILIARDE LEKE RRITEN PAGAT E USHTARAKEVE, JA SHITESA PER ÇDO KATEGORI

Ministri i Financave, Ahmetaj: Shtesë rrogash edhe për sistemin e drejtësisë, diplomatët, arsimtarët, mjekët e infermierët. Ndryshimet përkatëse



(Në foto) Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, dje gjatë një konference shtypi



KRIMI DHE PUSHTETI
Vetëngu në politikë, “Venecia” shqyrton në dhjetor nismën e PD. Hysi: Të konsultohemi
Ne faqet 5




KRITERET E KANDIDATEVE
Zbardhen emrat e 150 shkollave në vend, që do të pajisen me oficerë sigurie
Ne faqet 8

ME SHUME SHITES DROGE
Raporti i INSTAT-it: Veprat penale bien me 3.7%, një vrasje më shumë se në 2017-ën
Ne faqet 11

ISH-KRYEMINISTRI
Gjykata maqedonase vendos: Gruovski, më 8 nëntor në burg për abuzim me fondet
Ne faqet 19

THASHETHEMET E FUNDIT



Bën aksident, reperi në gjendje të rëndë shëndetësore. Ndahen Çiljeta me Albanin
Suplement

Zv.drejtoresha e arsimit në Pekin, Jin Honglian: Jemi të hapur për bashkëpunim

Universiteti “Luarasi”, mundësi bursash për në Kinë

Vizita e delegacionit kinez, Ethem Ruka: Bashkëpunim i frytshëm

NGA VOLTIZA DURO
Universiteti “Luarasi” ka pritur një delegacion me përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë në Kinë. Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme me universitete prestigjioze në mbarë botën,



stafi akademik i “Luarasi” diskutoi me delegacionin e arsimit kinez, mbi shkëmbimin e pedagogëve dhe mundësinë e dhënies së bursave për studentët. Gjithashtu, në takim u shqyrjuan mundësitë e punëve kërkimore të përbashkëta dhe shkëmbimi i ...
Ne faqet 9

PERGJIMET ARRESTIMET

Kreu i opozitës, akuza kryebashkiakut të Durrësit: Bashkëpunon me bandat

Valentina Madani

Për demokratët përgjimet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda ndaj kryebashkiakut të Durrësit janë provë e mjaftueshme që Vangjush Dako të merret i pandehur nga organi i akuzës. Vetë Lulzim Basha kërkon hapjen e një hetimi urgjent për vjedhjen e zgjedhjeve, ku Vangjush Dako të jetë i pandehuri i parë. Basha shkruan në fb: "Tashmë është e qartë për këdo se Edi Rama ka patur një plan të mirëmbanuar e të shtrirë anembanë vendit, për bashkëpunim me krimin për të vjedhur zgjedhjet. Duhet urgjentisht një hetim i posaçëm dhe i pavarur për këtë operacion kriminal. Vangjush Dako është i pari që duhet të merret i pandehur". Z.Basha paralajmëroi edhe dy drejtueset e prokurorisë: "Lënia e tij i lirë edhe pasi pranoi të enjten publikisht bashkëpunimin me bandat për të dhunuar zgjedhjet, është shkatërrim i demokracisë dhe vdekje e drejtësisë. Dua t'i kujtoj Donika Prelës dhe Arta Markut se dëmtimi i provave dhe manipulimi i hetimeve për krimet elektorale të Dakos, Ballës, Gjoknurit, Tahirit etj., është veprim i rëndë kriminal për të cilin, ato do të mbajnë shpejt përgjegjësi. Kur prokuroria mbron krimin, ka rënë shteti" - tha z.Basha.

Përplasja, Basha: Të merret i pandehur. Dako: Do shihemi në gjyq

Kreu i PD-së: Të nisin hetimet urgjentisht



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

MUSTAFAJ

Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj tha dje për 'News 24' se nga faktet që kanë dalë, Vangjush Dako duket se është i privilegjuar nga prokuroria në hetim. "Për sa i përket mesazhit që i ka dërguar Ramës, ne kemi parë se çfarë niodhi me Tahirin kur u bë ky mesazh, dhe kjo gjë më jep bindjen se këto kode janë efikase", - tha z.Mustafaj.

EDI PALOKA

Nënkryetari i PD-së shkruan se "Xhuxhi, 'supermani' e di gjithë Durrësi se është zari i 'të fortëve'. Sipas Palokës, ai i mohoi të gjitha, por të gjitha i dinë durrsakët dhe nuk i fsheh dot as sot e ca më shumë nesër kur të mos ketë as të gjatin, as Artën apo Donikën që ta mbrojnë. Janë aty pronat publike, tenderat, lejet e të gjitha favoret që iu ka bërë, jo vetëm një bandë".

që hanë, pinë, bëjnë pazare, bëjnë pushime, shesin e blejnë apartamente, vetura, gjithçka, me kriminelët e dënuar për drogë dhe pastaj marrin vendime sesa do të jenë taksat, sa do të jetë çmimi i naftës dhe çfarë do të bëjnë me pagat e shqiptarëve. Vetingu i politikaneve do të bëhet", u shpreh z.Basha.

LULZIM BASHA

"Lënia e tij i lirë edhe pasi pranoi mbrëmë publikisht bashkëpunimin me bandat për të dhunuar zgjedhjet është shkatërrim i demokracisë dhe vdekje e drejtësisë. Dua t'i kujtoj Donika Prelës dhe Arta Markut se dëmtimi i provave dhe manipulimi i hetimeve për krimet elektorale të Dakos, Ballës, Gjoknurit, Tahirit etj., është veprim i rëndë kriminal për të cilin, ato do të mbajnë shpejt përgjegjësi. Kur prokuroria mbron krimin, ka rënë shteti" - tha z.Basha.

"Vetëm maja e ajsbergut për 'xhuxhin"

Alibeaj: Dako në burg, Rama nuk e shpëton nga dosja 339

Demokratët insistojnë në arrestimin e kreut të bashkisë së Durrësit Vangjush Dako pasi sipas tyre ai bashkëpunon me kriminelët. Deputeti i PD-së Enkelejd Alibeaj delaroi dje se strategjia e Edi Ramës për të shitur bashkëpunimin me krimin si normalitet politik nuk e shpëton Vangjush Dakon nga dosja 339. Alibeaj u shpreh se deri tani ka dalë vetëm maja e ajsbergut. "Strategjia e Edi Ramës për të shitur bashkëpunimin me krimin si normalitet politik nuk e shpëton Vangjush Dakon nga dosja 339! Deri tani ka dalë vetëm maja e ajsbergut", -tha nënkryetari i grupit parlamentar i PD, Enkelejd Alibeaj. Ai përmendi se Vangjush Dako duhet të ishte sot në burg, pasi është kapur në përgjime me trafikantë ndërkombëtarë droge para, gjatë dhe pas zgjedhjeve për të blerë pushtetin kriminal të Edi Ramës. "Shembujt më flasantë të kësaj strategjie kriminale janë pranimiti i hapur i bashkëpunimit me krimin nga: Vangjush Dako me bandën e Avdyllajve dhe Lul Berishës. Taulant Balla me trafikantët e drogës mik të familjes, Edmond Bego, Arben Ndoka, Elvis Roshi, Mark Frroku, Armando Prenga, që pranojnë jo vetëm bashkëpunimin, por edhe kryerjen e krimeve prej tyre. Nuk ka tallje më të madhe për shqiptarët sesa për betimiti i Edi Ramës se po lufton krimin, ndërkohë që bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë konsiderojnë normalitet politik bashkëpunimin me krimin e organizuar", tha z.Alibeaj.



Berisha: Ndreu, pushime në Itali me të akuzuarin për trafik droge

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një fotografi ku shfaqet deputeti socialist Pjerin Ndreu në krah të Xhevahir Ndokës, vëllai i ish-deputetit Arben Ndoka, që sipas një mesazhi të qytetarit dixhital është bërë në Itali, ku ndodheshin me pushime. Berisha shkruan në Facebook se Ndreu e ka "xhan dhe shpirt" edhe vëllain e ish-deputetit Ndoka, të dy aktualisht në burg. "Me Ndokajt e drogës dhe të vjedhjes së tokave pushimet", - shkruan Berisha. "Në këtë selfie të kimit të bërë nga z.Pjerin Ndreu kur ishte për pushime në Itali bashkë me të akuzuarin për trafik droge dhe vjedhje pronash Xhevahir Ndoka, vëllai i ish-deputetit Arben Ndoka, në shoqërinë e tyre duket edhe Andi Marku, drejtori pronave shtetërore në prefekturën Lezhë, ku dhe gruaja e këtij të fundit është juriste në Hipotekën e Lezhës, z.Marku mban në emër të tij hektar tokë të klanit Ndoka bashkë me bashkëshorten e tij.

kam fajin as unë, as durrsakët, as shijakët as krutanët. Nuk ke votë! Je një peshk rezervati që nuk hahesh dot dhe hidhu përpijet sa të dush me kaseta me telefonata e me sajesa vemjesh. Ty nuk të beson askush o toçi i Saliut që i hap telefonin vetëm kunatit. Kurse mua më besojnë se ju hap telefonin të gjithëve dhe si kam

Spaho: Turp, Dako i quan kriminelët qytetarë si gjithë të tjerët

Kryetari i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho i quan turp deklaratat e kryetarit të bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako bërë në emisionin "Opinion". Spaho shprehet se për Dakon është normale që kriminelët të quhen qytetarë si gjithë të tjerët. "A e patë çfarë turpi!! Vangjush Dako i quan qytetarë si gjithë të tjerët kriminelët që takon gjatë zgjedhjeve, kriminelët që mban në shtabet elektorale, kriminelëve që iu jep leje ndërtimi, kriminelëve, të cilët blejnë vota. Unë kam 300 Njësi të gjithë Durrësin ta Gjushi. Me ta shtrjo dreka dhe darca ka t'i falënderuar për kontributin që dhanë në zgjedhje. Niçja është një kriminel i lidhur me laboratorin e Hasit dhe që ble vota në Durrës. E çfarë ka këtu, pyeti Gjushi, kjo është qesharake të merremi me gjëra të tilla. E njëjta gjë ka ndodhur me Ndokën në Lezhë. Këtu kemi katandisur me Rilindjen".

duart as me gjak, as me zhul eurosh si puna jote! Ti vazhdo dil e shpif përditë jo krimi, jo droga, jo leku jo byreku, se ka ardhur koha t'i marr edhe ca lekë unë nga thesi që të mban kunati ty. Do shihemi në gjyq bashkë ose, në fakt, jo, se ti merr raport mjekësor kur të thërrret gjykata. Toçi!", shprehet z.Dako.



Kryeministri Edi Rama dhe kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako



VANGJUSH DAKO

Kryebashkiaku i Durrësit u justifikua dy ditë më parë për bisedën e tij me Altin Avdylin duke thënë se ai bisedon me shumë njerëz dhe i falenderon për kontributin në zgjedhje. Dako tha se i kishte duart e pastra "akullore" dhe shtoi se nuk shihet asnjë arsye pse duhej të jepte dorëheqjen.

"VOL-VO 4"

Zbulohet njëri prej transportuesve të drogës në Has

Elis Bahushi është njëri nga 27 të arrestuarit i aku- zuar si i përfshirë në ngritjen e laboratorit të përpunimit të heroinës së Brenog të Hasit.

Lapsi shkruan se nga hetimet e deri tanishme dyshohet se, 35-vjeçari ka pasur rolin e transportuesit të lëndës narkotike dhe përbërësve të saj nga Turqia drejt vendit tonë. Disa hyrje dalje nga sistemi TIMS, ku Elis Bahushi ka udhëtuar më shpesh në Turqi, Maqedoni dhe Kosovë, provohen nga dokumentet. Organi i akuzës kërkon informacion nga homologët turq se kë ka takuar në Stamboll në datat 25 dhe 26 tetor Elis Bahushi, ku janë administruar edhe bilatat e tij të udhëtimit.

Uniformat blu pohojnë se Bahushi dhe familja e tij prej më shumë se 25 vitesh ushtrjnë aktivitetin e tyre tregtar në qytetin e Elbasanit, kryesisht në fushën e veshjeve dhe metrazhit. Furnizimin me lëndë të parë familja Bahushi e kryente në Turqi dhe për këtë arsye ka dyshime nga prokurorisë se, dy ekspertët turq, të cilët janë shpallur në kërkim nga policia shqiptare të jenë dërguar në vendin tonë nga 35-vjeçari Elis Bahushi.

Gjykata e Krimeve të Rënda, ditën e enjte ka vendosur të lërë në burg biznesmenin bashkë me mikun e tij Orges Jahelezi, masë e cila ishte vendosur më herët edhe nga gjykata e Elbasanit.



Misteri fati i dokumenteve të përgjimit, Niçja dialogon për t'u dhënë lekë votuesve

Përgjimet për shitblerje votash në Durrës, prokuroria nuk heton Dakon

Kryebashkiaku bisedon me të arrestuarin Altin Avdyli

Kryebashkiaku i Durrësit është përgjuar nga prokuroria duke folur në telefon me njërin prej të arrestuarve të operacionit "Volvo 4", Altin Avdylin, me pseudonimin Niçja. Në këtë bisedë të regjistruar dy ditë pas zgjedhjeve, vetë Dako i ka kërkuar atij të takojë Astrit Avdylin, të ashtuquajturin "bosin e Shijakut" për ta falënderuar. Në një tjetër përgjim, Niçja komunikoi me persona të tjerë në telefon, vetëm pak orë para zgjedhjeve të 25 qershorit 2017. Këta persona të tjerë e ftojë Altin Avdylin t'i thotë Vangjush Dakos të paguajë lekë për disa votues. Pavarësisht këtyre fakteve, prokuroria nuk ka nisur asnjë hetim për shitblerje votash që të implikojë kryebashkiakun e Durrësit. Misteri mbetet fati i përgjimeve dhe fakti se pse organi hetimor ka vendosur të mos i shkojë deri në fund zbardhjes së kësaj çështjeje.

DY BISEDAT E PERGJUARA

Biseda e parë është zhvilluar më datë 27 qershor në orën 11:08 të paradites ku thirrja bëhet nga numri 069 20 99 300 drejt numrit 069 89 67 XXX dhe zgjat 1 minutë e 3 sekonda. Biseda mes Avdyllaj dhe Dakos është zbardhur më 23 tetor 2017. Në dokumentin e Prokurorisë së Përgjithshme thuhet, gjithashtu, se personi që përdor telefonin e përgjuar është pikërisht numri 069 20 99 300 që i përket kryetarit të Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako.

Biseda e dytë është bërë mes Altin Avdyllaj dhe një personi tjetër që i kërkon t'i thotë Dakos të paguajë një familje që ka votuar për ta në zgjedhje.

BISEDA E PARË

Niçja: Hë kryetar, hë vllai. **0692099300:** Niçe, ku je? **Niçja:** Këtu vërdallë... **0692099300:** Ku është Astriti? **Niçja:** Ka lëviz një çikë. **0692099300:** Ku ka lëviz? Jashë Durrësit? **Niçja:** Eh... ç'ka? Ka ndonjë gjë? **0692099300:** Po jo mo, doja ta takojsha, ta falenderojsha, ta pyesja një çikë. **Niçja:** Po, po ku je ti? Të vij të takoj... Njësoj është, si ai si unë, e di që jemi një **0692099300:** Po mirë mo mirë, por doja ta



Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako

Jasin Avdul njofton mikun e tij në Sarandë se po vjen policia

"Fshehe atë m... atje", zbardhen rolet e tre policëve që ndihmonin Avdyllajt

Mes 34 të arrestuarve pjesë e dosjes së grupit të Shijakut janë edhe tre efektivi policie. Tre efektivet janë Ardin Gjyriqi, Bledar Koçi dhe Jasin Avdul. Gjyriqi ka mbajtur rolin efektivit kufitar në Morinë. Nga hetimet ka rezultuar se ai ka pasur kontakte me anëtarët të grupit të Avdyllajve. Ai dyshohet se ka lejuar persona të ndryshëm, për llogari të grupit, që të kalojnë kufirin Shqipëri-Kosovë në mënyrë të paligjshme.



Sipas dosjes, rezultoni se më datën 15 prill, ora 08:05, Gjyriqi është telefonuar një numër me prefiks të Kosovës. Pas përsëritjes, personi nga Kosova, i thotë Gjyriqit se nuk mundet të hyjë në Shqipëri, pasi i ka humbur një targë e makinës.

"Jam këtej se më ka hup një targë e makinës dhe nuk më lënë të hy. Kam ngel aty ku ishim atë ditë", i thotë ai. Ndërsa në një komunikim tjetër, Arditi pyet dikë, për hyrjen e një personi kosovar, që bëhet fjalë për shtetasin Besim Mahmuti.

Efektivi i dytë, Bledar Koçi ka qenë me detyrë punonjës i policisë në Fier, në sektorin kundër narkotikëve. Ai ka ndihmuar anëtarët e grupit kriminal, duke shfrytëzuar të dhënat dhe pozicionin e punës së tij.

Nga përgjimet, ka rezultuar se ai e ka ndihmuar Hajri Seferin, me disa gjopa që ka pasur për të paguar.

"O Hajri, jam ai i Fierit, se po të marr me një telefon tjetër, nuk është telefoni im. Ti kishe edhe 3 gjopa të tjera, për dy vitet e fundit ti ke katër gjopa dhe nuk paguan 60 mijë, minimalen paguan 120 nga 150 që ishte ajo", i thotë polici, ndërsa më pas lënë një ditë takimi për të diskutuar për çështjen.

I treti efektivi i arrestuar është Jasin Avdul i policisë së Sarandës. Sipas dosjes hetimore, ai ka lidhje me Klement Domerin, të cilin e njofton se po ndiqte policia kur ai po përpjeqë të trafikonte një sasi narkotikësh në Greqi. Bëhet fjalë për një bisedë të datës 15 shtator 2018 ku Jasin Avdul i thotë Klement Domerin: "Fshehe atë m... atje thuaj atij se më tha ai do të vijmë me makinë ata te gropa".

Nga përgjimet, ka rezultuar se ai e ka ndihmuar Hajri Seferin, me disa gjopa që ka pasur për të paguar.

"O Hajri, jam ai i Fierit, se po të marr me një telefon tjetër, nuk është telefoni im. Ti kishe edhe 3 gjopa të tjera, për dy vitet e fundit ti ke katër gjopa dhe nuk paguan 60 mijë, minimalen paguan 120 nga 150 që ishte ajo", i thotë polici, ndërsa më pas lënë një ditë takimi për të diskutuar për çështjen.

I treti efektivi i arrestuar është Jasin Avdul i policisë së Sarandës. Sipas dosjes hetimore, ai ka lidhje me Klement Domerin, të cilin e njofton se po ndiqte policia kur ai po përpjeqë të trafikonte një sasi narkotikësh në Greqi. Bëhet fjalë për një bisedë të datës 15 shtator 2018 ku Jasin Avdul i thotë Klement Domerin: "Fshehe atë m... atje thuaj atij se më tha ai do të vijmë me makinë ata te gropa".

takoja...kanë pi ato. **Niçja:** Po, e di po, kanë lëviz... Me të taku një çikë unë ty!

0692099300: Unë tani jam duke ardh nga... rrugës... rrugës...

BISEDA E DYTË

Biseda e dytë është bërë nga numri i telefonit 069 56 39 642 (i paidentifikuar) drejt

numrit 0898967XXX (Altin Avdyllaj) në orën 20:06 të mbrëmjes me kohëzgjatje 31 sekonda një ditë para zgjedhjeve të 25 qershorit.

Niçja: Të marr unë se jam me rob pra... Alo, ç'po bën?

Niçja: Të marr unë se jam me rob të thashë! Ku je? Je andej nga fsha-

trat, ku ishe? Jo! Jo! Jo! Kam ca me mbiemër Kur-ti, kam zonjën këtu... po deshe...

Niçja: ...mirë... 6 veta janë!

Niçja: Hajt se të marr unë! Thuaj Vangjushit t'i japim ndonjë lek, që të votojnë!

QEVERISJA AKUZAT

Përplasja qeveri-opozitë, Gjonaj: Asnjë tender për personat me çështje penale

Valentina Madani

Të dënuarit për vepra të rënda penale përjashtohen nga përfitimet publike, si tendera apo para të taksapaguesve. Këshilli i Ministrave miratoi dje një paketë të ndryshimeve ligjore, që ndalon përfitimet e të mirave publike nga persona fizikë apo individë të dënuar për një sërë veprash të rënda penale që lidhen me krimin dhe organizuar, trafikimin dhe terrorizmin dhe korrupsionin. Në një konferencë për mediat, ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj sqaroi paketën e re të ndryshimeve ligjore të miratuara në qeveri, që ka për qëllim luftën kundër kriminalitetit. "Falë kësaj pakete dhe hyrjes në fuqi të masave do ndalohej çdo lloj mundësie që kjo kategori individësh, shoqërisht tregtare dhe aksionere dhe përfaqësues të tyre të përfitojnë para nga taksapaguesit shqiptarë apo të përfitojnë mbështetje financiare nga fondet publike për ushtrimin e aktivitetit të tyre fitimprurës", deklaroi zj. Gjonaj. Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj doli në një deklaratë për median mesditën e sotme pas mbledhjes së qeverisë. Me hyrjen në fuqi të paketës së re do të përjashtohen edhe aksionerët, administratorët apo individë të tjerë me rol vendimmarrës në këto shoqëri tregtare, të cilat janë ose kanë qenë të dënuar në cilësinë e tyre individuale. "Me këtë paketë ligjore parashikohet që nuk do të mund të përfitojnë tendera publike apo koncesion asnjë kompani që jo vetëm rezulton e dënuar si subjekt juridik, por edhe në rastet kur të dënuar rezultojnë administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit, ortakët apo aksionerët", theksoi ministrja Gjonaj. I njëjti ndalim do të aplikohet edhe për përfitimet e statusit të investitorit strategjik, përfitimim për lehtësira në fushën e turizmit dhe të ndihmës shtetërore.

REAGIMI

Këshilltari ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi iu përgjigj dje deklaratave të ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj, për moslejimin e personave me precedentë kriminalë që të marrin pjesë në tenderat publike. Sipas demokratit Bardhi, ligji që ndalon personat me precedent penalë që fitojnë tendera publik është miratuar që në vitin 2006, por ky ligj sipas Bardhit nuk është zbatuar nga qeveria e Edi Ramës. "Neni 45 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se organet shtetërore duhet të përjashtojnë nga një procedurë prokurimi çdo person për të cilin ka të dhëna se ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së

Replika, PD: Balili e Bego përfituan miliona euro nga tenderat publike

Bardhi: Ligji u miratua në 2006, Rama nuk e zbatoi



Senatorja franceze: Macron dëshiron të vizitojë Tiranën

Kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme, Mimi Kodheli, priti dje senatoren franceze, Helene Conway-Mouret. Pas takimit, Kodheli dhe senatorja franceze dolën në një konferencë për shtyp. Mouret u shpreh se Franca mbështet integritimin e Shqipërisë në BE, ndërsa Presidenti Macron dëshiron që të vizitojë Tiranën. "Motivimi juaj është shumë i fortë për të ndryshuar vendin dhe një dëshirë e madhe për të qenë pjesë e BE-së. Shqipëria po bën përpjekje të mëdha për të ecur përpara në drejtimin e duhur. Ne kemi nevojë për njëri-tjetrin për të forcur bashkëpunimin sidomos në mbrojtje. Emanuel Macron dëshiron të vizitojë Shqipërinë dhe e di që edhe ju e prisni", tha Helene Conway-Mouret. Ndërsa Kodheli vlerësoi mbështetjen e Francës.

prerë për pjesëmarrje në organizata kriminale. Me ardhjen në pushtet të Edi Ramës, ky ligj nuk u zbatua dhe tenderat, koncesionet, PPP-të ranë në duart e trafikantëve të drogës dhe personave të tjerë të përfshirë në krimin dhe organizuar. Të shkruash me fjalë të tjera atë që

Ambasadori rus: Periudhë jo e lehtë në marrëdhëniet me Shqipërinë

Gjatë një takimi kulturor të organizuar mesditën e dje në qytetin e Beratit, ambasadori rus në vendin tonë, Aleksandër Karpushin, ka deklaruar se marrëdhëniet me Shqipërisë dhe Rusinë kanë ende shumë probleme. Karpushin deklaroi se, edhe pse Rusia dhe Shqipëria gëzojnë një marrëdhënie të hershme të bazuar në miqësi dhe respekt reciprok, aktualisht po kalojnë një periudhë jo të lehtë, atë të rivendosjes së lidhjeve dypalëshe, mes tyre e cila ishte ndërprerë për gati 30-vjet. Sipas Karpushin, ky proces fatkeqësisht është shumë i ngadalë, sidomos në fushën ekonomike dhe tregtare, ndërkohë që në fushën kulturore dhe humanitare bashkëpunimi mes dy vendeve po zhvillohet në mënyrë mjaft dinamike. Deklarata e ambasadorit



rus, Aleksandër Karpushin, u bë gjatë një aktiviteti të organizuar në bibliotekën "Vexhi Buharaja" të qytetit, ku ai ishte i pranishëm në promovimin e librit "Këngë Ruse", të profesorit beratas, Miltjadh Bode, njëkohësisht ish-ambasador i vendit tonë në Poloni dhe Korenë e Veriut. Në lidhje me librin, ambasadori Karpushin pohoi se në këtë vepër voluminoze me

Taulant Ballës, Edmond Bega, që ka përfituar 14 milionë euro nga punë publike, si dhe leje dhe licenca. Klement Balili, në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, ka përfituar 77 tendera, nga të cilat 30 pa garë. Edison Sali, anëtar i bandës së Agron Xhafajt ka përfitu-

GJONAJ
"Me këtë paketë ligjore parashikohet që nuk do të mund të përfitojnë tendera publike apo koncesion asnjë kompani që jo vetëm rezulton e dënuar si subjekt juridik, por edhe në rastet kur të dënuar rezultojnë administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit, ortakët apo aksionerët", theksoi ministrja Gjonaj.

BARDHI
"Neni 45 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se organet shtetërore duhet të përjashtojnë nga një procedurë prokurimi çdo person për të cilin ka të dhëna se ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për pjesëmarrje në organizata kriminale. Me ardhjen në pushtet të Ramës, ky ligj nuk u zbatua dhe tenderat, koncesionet, PPP-të ranë në duart e trafikantëve të drogës".



Gjatë një seance parlamentare



Bashkëpunimi shumëpalësh, Bushati vizitë në Spanjë

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, gjatë punimeve të Konferencës Mesdhetare në Malaga të Spanjës, zhvilloi disa takime me homologë si dhe me Sekretarin e Përgjithshme të OSBE, Thomas Greminger. Ministri Bushati u takua me ministrin e Jashtëm të Sllovakisë Miroslav Lajcak, vendi i të cilit për 2019-ën; me ministrin e Jashtëm të Serbisë Ivica Dacic, me zëvendësministrin e Jashtëm të Italisë Guglielmo Picchi, vendi i të cilit ka kryesinë aktuale të OSBE-së. Zyratë diskutuan mbi sfidat aktuale me të cilët përballen OSBE dhe nevojën e adresimit të tyre. Ministri Bushati dhe sekretari Greminger diskutuan mbi zhvillimet në rajon dhe sfidat, të cilat duhen adresuar me synim shfrytëzimin e plotë të potencialit të organizatës në përballjen e tyre. Bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime mbi vlerat e OSBE-së si organizatë rajonale me rëndësi specifike në botë, me një sistem të balancuar të angazhimeve politike, të bazuara në një koncept të sigurisë gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, e cila ofron një platformë për tejkalimin e sfidave të sigurisë.



PS, Hysi: Gjithë kjo periudhë do përdoret për të bërë konsultimin publik

Vetingu në politikë, "Venecia" shqyrton në dhjetor nismën e PD-së

Salianji: Përshpejtim të procesit, krimi në pushtet

Valentina Madani

Brenda dhjetorit pritet të mbërrijë në Tiranë opinioni i Komisionit të Venecias, lidhur me nismën kushtetuese të opozitës për vetingun në politikë. Lajmin e bëri të ditur për mediat socialistja Vasilika Hysi gjatë mbledhjes së për-bashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve, ku opozita u përfaqësua vetëm me deputetin Ervin Salianji pas marrëdhënies së kushtëzuar që ka vendosur me parlamentin. "Për dijeni Komisioni i Venecias ka kthyer përgjigje se do ta shqyrtojë në dhjetor. E gjithë kjo periudhë do të përdoret për të bërë konsultimin publik", njoftoi zj.Hysi. Opozita përmes Salianjit kërkoi përshpejtim të procesit dhe i cilësoi seancat dëgjimore me grupet e interesit si taktikë të mazhorancës për ta shtyrë nismën e saj në kalendarin grek. Salianji u shpreh se me përgjimet e publikuara deri tani për funksionarët e saj, mazhoranca duhet të kërkojë falje publike dhe të pranohet vetingun në politikë, jo të bëjë konsultime farsë dhe më pas u largua pa dëgjuar deputetët socialistë Vasilika Hysi, e cila tha se konsultimet po kryen në pritje të opinionit të Komisionit të Venecias që vjen në dhjetor. "Është e qartë se mazhoranca nuk e do vetingun e politikës dhe është e qartë se qytetarët shqiptarë duan njëherë e mirë, sidomos pas zbulimit të ngjarjeve të lidhjes së politikanëve me krimin, të shkëputen njëherë e mirë lidhjet e politikanëve me krimin. Ne si PD kemi kërkuar kontrollin e integritetit të politikanëve, të lidhjes së tyre me krimin dhe kontrollin e pasurisë së politikanëve. Këtu nuk besoj se ka qytetar që i do. Nuk besoj se ka qytetar që nuk traumatizohet kur kryetarë bashkie të zgjedhur nga PS thonë se 'unë e njoh Niçen' dhe na i shesin si normalitet", deklaroi z.Salianji. Deputeti i PD-së përmendi se: "Në 5 vite ato që ne kemi thënë si opozitë, sot po dalin qartazi të lidhur me krimin. Atë që ne kemi kërkuar dhe kërkim më forcë sot, që gjenden në përgjimet e prokurorisë dhe përgjimet e partnerëve, këta zotërinj mund të dënohen siç ndodhi me ish-deputetët e PS, që t'u vijë radha pas 5 vitesh apo edhe më shumë.



Mbledhja e djeshme e Këshillit të Legjislacionit

ERVIN SALIANJI

"Është e qartë se mazhoranca nuk e do vetingun e politikës dhe është e qartë se qytetarët shqiptarë duan njëherë e mirë, sidomos pas zbulimit të ngjarjeve të lidhjes së politikanëve me krimin, të shkëputen njëherë e mirë lidhjet e politikanëve me krimin", theksoi deputeti i PD-së.

Slogani i zgjedhjeve, Veliaj: Mbështesni PS-në masivisht

Kreu i bashkisë, Erion Veliaj vijoi edhe dje turin e dëgjësave për 'Buxhetin 2019' dhe projektet transformuese në Njësinë 2. Veliaj vlerësoi vendimin e deputetëve të mazhorancës për t'i hapur rrugë ndërtimit të një godine të re moderne dhe funksionale të teatrit. Ai tha se koha po tregon se ata që janë kundër teatrit, janë të njëjtët që duan edhe pikat e basteve. Ndaj, ai kërkoi prej qytetarëve një mbështetje masive në zgjedhjet e ardhshme për PS-në, në mënyrë që ritmi i punëve në këtë qytet të mos ndalet. Gjatë takimit Veliaj ka zbuluar edhe sloganin e zgjedhjeve, i ngjashëm me atë të mazhorancës "E gjithë vëmendja për ju". "Një vendim tjetër i jashtëzakonshëm që mori parlamenti ishte ai për teatrin e ri. I jam sot mirënjohës Edi Ramës, Partisë Socialiste, 74 deputetëve, që votuan teatrin sepse besoj vetëm kur vëmë dorë ecin gjërat përpara. Tani, imagjini pak logjikën e këtyre, këta thonë 'mos, nuk e duam teatrin, duam baste!' Ne themi 'nuk duam baste, duam teatrin!' Nuk besoj se ka njeri normal, nuk ka rëndësi i majtë apo i djathtë, që thotë nuk e dua teatrin se dua baste. Sot politika është ndarë në këto dy tema: PS u thotë 'jo' basteve, pro teatrit! Partia tjetër thotë 's'duaam teatër, duam baste!' Kushdo që do të shkojë të votojë vitin tjetër për kryetarin e bashkisë ose për këshillin bashkiak duhet të mendojë e të thotë: 'mirë kryetarin e bashkisë, por me votën e Këshillit Bashkiak nuk bëj më qokë, do t'ia jap vetëm PS-së, sepse vetëm ajo ma garanton që kryetari i bashkisë mbështetet për të bërë këto lloj punësh", tha Veliaj.

Kryeministri Rama: Kontradikta e pashmangshme me ambasadorin e BE

Nga Shkallnuri i Durrësit, teksa ishte në takim me fermerët për prezantimin e programit të ri IPARD, me 94 mln euro mbështetje për investime në bujqësi, agropëpunim dhe zhvillimin rural, kryeministri Edi Rama nuk i kurseu batutat. Këtë radhe, duke përfshirë edhe ambasadorin e BE-së, Luigi Soreca, që e kishte në krah gjatë takimit. Ai tha se me ambasadorin janë në një kontradiktë, pasi ai vetë është me Juventusin, ndërkaq ambasadori me Napolin, që aktualisht janë në vendim e parë dhe të dytë. "Kemi një kontradiktë të pashmangshme që do të mbetet deri në fund se ambasadori është me Napolin, unë dihet se me kë jam. Sa herë e shoh, më vjen keq se është gjithmonë i dyti, por sidoqoftë po e mbajtët vendin e dytë në raport me ne jemi mirë të dyja palët. Të paktën në këtë rast. Merreni si të doni ju këtë tani", tha z.Rama.

Meta takon Scheuer: Gjermania, donatori më i madh në Shqipëri

Cështjet e bashkëpunimit ekonomik, sidomos financimi i projekteve infrastrukturore dhe energjetike ishin në qendër të takimit të djeshëm të Presidentit Ilir Meta, me ministrin e Transportit dhe Infrastrukturas Dixhitale të Republikës Federale të Gjermanisë, Andreas Scheuer. Në fokus të takimit ishin çështjet e bashkëpunimit ekonomik, sidomos financimi i projekteve infrastrukturore dhe energjetike, ku Gjermania është donatori më i madh në Shqipëri, me investime financiare mbi 1 miliard euro në këto 30 vite. Presidenti Meta shprehu falënderimet për mbështetjen financiare të Gjermanisë në fusha si energjetika, infrastruktura, bujqësia, turizmi, shëndetësia, SME-të dhe arsimit profesional. Në



TAKIMI
Presidenti Ilir Meta mikpritur dje rreth 50 fëmijë nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Gjermania, Rusia dhe Ukraina, të cilët marrin pjesë në veprimtarinë "International Kids Fashion Week Albania".

mënyrë të veçantë, Presidenti Meta vlerësoi interesin e palës gjermane për të fuqizuar bashkëpunimin ekonomik me Shqipërinë përmes KfW dhe GIZ në sektorë vitalë siç janë sistemi i ujësjellës-kanalizimeve me fokusin e një pjesë, zhvillimi rural, bujqësia dhe agroturizmi, si dhe menaxhimi i mbetjeve. Gjithashtu, Presidenti Meta vuri theksin edhe

tëk rëndësia e arsimit profesional, ekonomia dixhitale dhe teknologjia e informacionit, si bazat e një modeli ekonomik, ku Shqipëria ka shumë për të mësuar nga eksperiencia gjermane. Z.Meta i shprehu ministrit Scheuer interesin dhe gatishmërinë maksimale për të rritur prezencën e kompanive private gjermane në tregun shqiptar.

Por, në kërkime që sot pa asnjë vonesë të bëhet kontrolli i integritetit dhe pasurisë së politikanëve, njësoj si me gjyqtarët dhe policët. Nuk ka më arsye pse politikanët të jenë të privilegjuar në këtë shoqëri. Nuk ka arsye për ta shtyrë në kalendarin grek këtë proces", deklaroi deputeti i PD-së. Salianji para se të largohet nga mbledhja kërkoi: "Sot duhet të ishte dita kur ju si mazhorancë duhet të kërkonit ndjesë për ata përfaqësues i keni futur në parlament dhe sot dalin me lidhje të forta me krimin

dhe kriminelët". Të thirrur në konsultë ishin shoqatat e biznesit, të cilët ishin dakord me këtë nismë të opozitës, edhe pse ky propozim mund të përmirësohet. "Propozimin e PD-së e shohim me shumë interes që të imple-

mentohet, mundësisht nga e gjithë klasa politike", deklaroi kreu i Dhomës së Tregtisë, Nikolin Jaka. Javën e ardhshme në konsultim me Këshillin e Legjislacionit do të jenë organizatat ndërkombëtare.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përmesimtare "Bëst 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 26 nëntor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmesimtare do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e a) nr.pasurisë 26/106+1-26, vol 52, fq.1, ZK.8603, sip. 105 m² me çmim fillestar 2976750 lek; b) nr.pasurisë 26/187-ND, vol 52, fq.28, sip.513.4 m² me çmim fillestar 22640940 lek

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIJ J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Ministri i Financave: Ndryshimet në buxhet dhe paketën fiskale

Ahmetaj: Rriten pagat në arsim, shëndetësi, drejtësi e diplomaci

"Vazhdojmë konsolidimin fiskal dhe uljen e borxhit"

Rriten pagat në arsim, shëndetësi drejtësi dhe diplomaci. Kjo është bërë e ditur nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj gjatë prezantimit të buxhetit të vitit 2019 dhe paketës së re fiskale. Dje pasdite draftbuxheti i aprovuar nga qeveria shkoi në Kuvend, ku do të fillojë diskutimi në komisione deri në momentin e aprovimit të tij. Sipas ministrit rritja ekonomike për vitin 2019 projektohet në nivelin 4.3% e Prodhimit të Brendshëm Bruto ndërsa deficitit buxhetor për vitin 2019 është planifikuar të jetë -1.9% e Prodhimit të Brendshëm Bruto që është niveli më i ulët historik i deficitit buxhetor. "Për të katërtin vit radhazi qeveria Rama nuk prodhon borxh të ri, por krijon suficit, i cili shkon në adresimin dhe pagesën e borxheve të trashëguara ndër vite. Megjithatë jemi duke ulur borxhin publik, prapë do të kemi një nivel investimesh të konsiderueshme prej 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Pra, qeveria si aktor ekonomik, nëpërmjet investimeve publike, që shkojnë rreth 900 milionë dollarë". Tha ministri i Ekonomisë dhe Financave Arben Ahmetaj.

ARSIMI

Arsimi do të vazhdojë të jetë mbi 3% e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe, do të ketë rritje të pagave të mësuesve rreth 7%. Do të vazhdojë ofrimi i teksteve shkollore falas për 190 mijë nxënës të arsimit para-universitar, nga të cilët 125 mijë nxënës të klasave I-IV; transporti falas për 28 mijë nxënës dhe 10 mijë mësues; trajtimi me kuotë ushqimore për 1000-1400 nxënës. Ndërkohë, do të vazhdohet me projektet e shkollave të reja.

SHËNDETËSI

"Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbro-



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

jtjes Sociale rritet në terma nominalë me mbi 24 milionë dollarë apo 2.4 miliardë lekë, ku kemi përfshirë bonusin e lindjeve dhe pagat, të cilat mbahen si politike më vete pagash në tabelën e buxhetit"-tha ministri Ahmetaj ndërsa do të vazhdojë iniciativa e ndërmarrë nga ministria dhe kryeministri për rikonstruksionin e të gjithë qendrave shëndetësore që do të jenë 100 në të gjithë vendin. Po kështu një sërë spitalësh do të kalojnë në rikonstruksion të plotë, si spitali i Lushnjës, Elbasanit, Vlorës, Beratit, Lezhës, Pogradecit, Matit.

BUJQËSIA

Viti 2019 fare thjesht mund të quhet dhe viti i bujqësisë, gjithashtu. Do të vazhdojë mbështetja buxhetore prej 2.6 miliardë, pra

për fermerët, por lajm i mirë është që do të vazhdojë dhe skema IPARD e në funksion të IPARD-it është akorduar nga qeveria shqiptare një financim prej 1 miliard, që të kemi mundësi të tërheqim 3 miliardë lekë nga IPARD-it për sektorin e bujqësisë.

DREJTËSIA

Dua të theksoj se buxheti i vitit 2019 financon plotësisht reformën në drejtësi, të dyja korsi të kryesore financiare të reformës në drejtësi: rritjen e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët dhe financimin e krijimit të të gjitha institucioneve të reja të reformës në drejtësi dhe financimin e plotë të vetingut. Shkon më shumë se 2.2 miliardë. Do të finanohen institucionet KLP, KLGJ, Byroja e Hetimit dhe SPAK-u me 500 milionë lekë.

PAKETA FISKALE

- Mbi 15 mijë punëmarrës përfitojnë nga ulja e normës së tatimit mbi pagat e nivelit të mesëm dhe të lartë
- 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit nga ulja e normës së tatimit mbi dividendin, nga 15% në 8%
- Mbi 50 Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor nga incentivimi i fermerëve të bashkuar, inkuorpuar
- Nga ulja e taksave të ndryshme si ajo e ambalazhit, e kërkuar me vite e vite, përfitojnë ulje kostoje dhjetëra operatorë të fushës
- Nga përjashtimet e parashikuara në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, lehtësohet veprimtaria e qindra operatorëve ekonomikë në industrinë e fasonit, makinerive bujqësore dhe farmaceutikës.

BEBET

Nga iniciativa e fundit e kryeministrit, e quajtur dhe bonusi i bebeve, përmes shpërblimit të lindjeve parashikohet të përfitojnë rreth 30 mijë familje me një fond total prej 2 miliardë lekësh.

INVESTIMET NE INFRASTRUKTURE

- Rruga e Arbrit
- Thumanë-Vorë-Kashar
- Milot-Balldren
- Orikum-Dukat
- Vazhdimi i financimit për akset rrugore
- Kardhiq-Delvinë, Lotet 4,5,6,7 dhe 8
- Fushë Krujë-Milot-Morinë
- Qafë Thanë-Lin-Pogradec
- Unaza Verilindore e Tiranës
- By Pass Tepelenë
- By Pass Shkodër
- Fillimi i tunelit "Kardhiq-Delvinë"
- Finalizimi i ndërtimit të linjës së hekurudhës Tiranë - Durrës dhe Tiranë - Rinas (Aeroport)
- Vitin tjetër do të bëhet i kalueshëm dhe By Pass-i i Fierit dhe do të avancohet puna në By Pass-in e Vlorës
- Do të bëhet plotësisht i kalueshëm autostrada e Elbasanit

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k, propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORCA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtitimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e lincensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjës Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mblodhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjësja Publike do të mbahet në datën 26 Tetor 2018 në orën 12:00 ne sallën e takimeve tek "Grand Hotel Korça"



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BANKA E SHQIPERISE

DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT

SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve të rrjetit për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 12,700,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(Ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve të rrjetit për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 23 Nentor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

PAGESAT

Pronarët mund të aplikojnë për të përfutur nga skema për pagesa të përshpejtuara. Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh.

Pozicioni	Paga maksimale për Gradë 2018	Rritja 5 % - Viti 2019		
		Rritja në %	Rritja në vlerë leke/muaj	Paga maksimale për gradë leke/muaj
Bjeneral Lejtnant Admiral	169.500	5%	8.475	177.975
Bj.Major (Nenadmiral)	162.000	5%	8.100	170.100
Bj.Brigrade (Kunderadmiral)	127.500	5%	6.375	133.875
Kolonel (Kapiten I rangut I-re)	110.000	5%	5.500	115.500
Nenkolonel (Kapiten i rangut II-re)	89.700	5%	4.485	94.185
Majror (Kapiten i rangut III-re)	74.300	5%	3.715	78.015
Kapiten (Lejtnant)	61.200	5%	3.060	64.260
Togër (Lejtnant)	58.900	5%	2.945	61.845
Nentogër (nenlejtnant)	53.500	5%	2.675	56.175
K/Kapitër	64.150	5%	3.208	67.358
Kapitër	58.600	5%	2.930	61.530
Rreshitër	53.600	5%	2.680	56.280
etar	46.750	5%	2.338	49.088
Nentetar	45.250	5%	2.263	47.513
Jshitare detar IV	44.100	5%	2.205	46.305
Jshitare detar III	38.100	5%	1.905	40.005
Jshitar II/Detar II	36.650	5%	1.833	38.483
Jshitar I/Detar I	33.600	5%	1.680	35.280

APLIKIMET

Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë.

Për vitin 2019, 5 miliardë lekë do t'u ndahen pronarëve

Buxheti, rriten pagat për 6800 ushtarakë

Tabela me kategoritë dhe shtesat përkatëse

5

MIJE PRONARE
Janë 5 mijë pronarë, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit të pronës dhe s'kanë marrë deri tani asnjë kësht. Fondi është i ndarë në tri vite 2019-2022, i cili rritet progresivisht vit pas viti.

Në vitin 2019 do ketë rritje pagash për 6800 ushtarakë, shesë e cila varion nga 1.680 lekë deri në 8.475 lekë, në varësi të gradës e detyrës. Rritja e pagave në sektorin e mbrojtjes parashikohet të jetë në nivelin 5 përqind ndër-sa fondi vjetor për këtë rritje vlerësohet rreth 300 milionë lekë. Gjenerali Lejtnant Admirat do të marrë më shumë në sektorin e mbrojtjes, por edhe kategoritë e detarëve do të përfutojnë shtesën mujore të pagesës. Vetëm pak ditë më parë Rama u shpreh në lidhje me rritjen e pagave në sektorin e Mbrojtjes ku u shpreh i kënaqur me arritjen e qeverisë së tij dhe rritjen faktike të pagave.

PRONARËT

Për vitin 2019, fondi i kompensimit të pronarëve është parashikuar në vlerë 5 miliard lekë. Referuar projektbuxhetit të vitit 2019, ky fond do të krijohet përmes kontributit 4 miliardë lekë nga buxheti i shtetit dhe 1 miliardë lekë nga të ardhurat e tjera. Ndërkohë pronarët mund të aplikojnë për të përfutur nga skema për pagesa të përshpejtuara. Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së futurës, pavarësisht brenda tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë



Foto ilustruese

3

VITET

Në projektbuxhetin afatmesëm është miratuar fondi për vitin 2019 në vlerën 4.9 miliardë lekë, për vitin 2020 në vlerën 5.3 miliardë lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 5.4 miliardë lekë. Sipas ligjit në fuqi, pronarëve që u është njohur e drejta për kompensim do të marrin 20% të vlerës në lekë dhe pjesën tjetër 80% kompensim me tokë.

nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë

pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehen vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i ko-

mpensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese që shprehen vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të

PERFITUESIT NGA RRIJJA E PAGAVE

- Në shëndetësi përfutojnë 4650 mjekë dhe 13765 infermierë, në total 18415 punonjës me një fond vjetor mbi 1 miliard lekë;
- Në arsim përfutojnë 35783 staf mësimor me një fond vjetor prej rreth 1.4 miliardë lekë;
- Në mbrojtje përfutojnë 6800 ushtarakë, më një fond vjetor prej rreth 300 milionë lekë;
- Në sistemin penitenciar përfutojnë 3560 policë të burgjeve më një fond prej gati 200 milionë lekë në vit;
- Do të ketë një rritje të ndjeshme të pagave të diplomatëve shqiptarë me mbi 20 %

veçantë duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin finan-

ciar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

Njoftim për shitje me ankand të tretë
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e dorezuesin K Sula të ndodhur në Mallakaster. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:
* Pasuria "Ara" me nr. 206/16, me sipërfaqe 2500 m², në ZK 2869 vol. 5 fq.31, dhe "Ara" me nr.206/7 me vol.4, faqe 244, në ZK 2869 vol me sipërfaqe 500 m².
Ankandi tretë i sipërfaqes totale 3.000 m² fillon me cimin fillëstar 806.400 lekë
* Pasuria "Ndertesë" pjesë e veuar me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m² e ndodhur në ZK 2869 Ankandi tretë fillon me cimin fillëstar 252.419 lekë
Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet që 23.11.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishat" Kulla 1, Kati 2, Zyra 5. Kont tel: 0672082543, e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

Njoftim për shitje me ankand
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 567,568 e vijues te K.Pt.C do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e pales debitorë B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:
* "Tsuall" e Godinë tre kateshe , me numer pasurie 14/283 në Z K Nr:8602, volumi 35, faqe 144, ttuall 300 m², sipërfaqe e kati per dhe 117,9 m² në Lagjen 10 Korrikunare Vlore
Ankandi i pasurisë fillon me cimin fillëstar në masën prej 9.960.000 Lekë
Ankandi çendron i hapur 15 ditë dhe do të zhvillohet në datë 08.11.2018 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 2.Tiranë Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

STRATI Shqoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të paluajtshme:
- "Dyqan", me sipërfaqe 60 m², ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 6310, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 518, datë 13.03.2007, në pronësi të Shoqërisë "LIM-EM" sh.p.k. lënë si garanci hipotekore për Bankën Tiranë s.h.a me Kontratë Hipotekore Nr. 1201 Rep., Nr. 800/3 Kol., datë 13.03.2008. Cimi fillëstar i ankandit është 48.082 Euro.
- Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 31.10.2018.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

UNIVERSITETI "LUARASI" BASHKËPUNIMI

Zv. drejtoresha e arsimit në Pekin, Jin Honglian: Jemi të hapur për bashkëpunim

Universiteti "Luarasi" pret delegacionin kinez për arsimin, mundësi bursash për studentët

Ethem Ruka: Bashkëpunim i frytshëm në të ardhmen

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" ka pritur një delegacion me përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë në Kinë. Në kuadër të bashkëpunimeve të vazhdueshme me universitetet prestigjioze në mbarë botën, stafi akademik i "Luarasi"-t diskutoi me delegacionin e arsimit kinez, mbi shkëmbimin e pedagogëve dhe mundësinë e dhënies së bursave për studentët. Gjithashtu, në takim u shqyrtuan mundësitë e punëve kërkimore të përbashkëta dhe shkëmbimi i informacioneve në fushën e kurrikulave ndërmjet universiteteve kineze dhe Luarasit. Rektori i Luarasit, profesor doktor Ethem Ruka prezantoi universitetin para delegacionit e më tej dekanët pasqyruan punën e 3 fakulteteve në këtë institucion të arsimit të lartë. Rektori i Luarasit, prof. dr. Ethem Ruka tha se ky takim ishte tejet interesant dhe theksoi se bashkëpunimi me universitetet në Kinë do të jetë i frytshëm në të ardhmen. "Ky ishte një



Rektori i "Luarasit", profesor doktor Ethem Ruka



Delegacioni i arsimit kinez

Në këtë takim ishte e pranishme edhe zëvendës drejtoresha e arsimit të lartë pranë Bashkisë së Pekinit Jin Honglian, e cila shprehu mirënjohjen për mikpritjen e stafit akademik të Luarasit. Ajo më tej theksoi se universitetet kineze kanë dëshirën e madhe për bashkëpunime me këtë universitet. "Në takim më bëri më shumë përshtypje mikpritja e rektorit, pedagogëve dhe stafit akademik të Luarasit. Ata treguan, gjithashtu, një interes shumë të lartë për bashkëpunim me universitetet kineze në të ardhmen. Unë besoj dhe shpresoj që bashkëpunimi me "Luarasi"-n të jetë sa më i afërt pasi vura re që disa degë studimi në këtë universitet janë të përfërta ose njësoj me degët tona. Dëshiroj shumë që të shkëmbejmë eksperiencën me universitetin Luarasi"-u shpreh zëvendës drejtoresha e arsimit të lartë pranë Bashkisë së Pekinit Jin Honglian. Në fund të takimit, delegacioni kinez i dhuroi universitetit "Luarasi" disa dhurata simbolike në shenjë mirënjohjeje për mikpritjen dhe profesionalizmin e stafit akademik.

ETHEM RUKA

"Ajo që më bëri përshtypje ishte gatishmëria e të gjitha këtyre institucioneve për të bashkëpunuar me 'Luarasin', qoftë në shkëmbim pedagogësh, në ofrimin e bursave të studimit për studentët, punë kërkimore të përbashkëta. Tani kemi vendosur kontaktet dhe shpresoj që ky bashkëpunim të jetë i frytshëm në të ardhmen", - tha Ruka.



JIN HONGLIAN

"Në takim më bëri më shumë përshtypje mikpritja e rektorit, pedagogëve dhe stafit akademik të 'Luarasit'. Unë besoj dhe shpresoj që bashkëpunimi me 'Luarasin' të jetë sa më i afërt, pasi vura re që disa degë studimi në këtë universitet janë të përfërta ose njësoj me degët tona", - u shpreh Jin Honglian.



takim me të vërtetë interesant, një takim pune. Ishte

rasti i parë që ne takohemi me përfaqësues të shkollave

të larta të Kinës. Pritëm në universitet, përfaqësues të

të universiteteve të Pekinit, pra një grup që udhëhoqje nga zv. drejtoresha e arsimit të lartë pranë Bashkisë së Pekinit. Ajo që më bëri përshtypje ishte gatishmëria e të gjithë këtyre institucioneve për të bashkëpunuar me "Luarasi"-n, qoftë në shkëmbim pedagogësh, në ofrimin e bursave të studimit për studentët, punë kërkimore të përbashkëta. Tani kemi vendosur kontaktet dhe shpresoj që ky bashkëpunim të jetë i frytshëm në të ardhmen", -tha Ruka në fjalën e tij.

**PËRSHTYPJET MBI
UNIVERSITETIN
"LUARASI"**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Automatizimi i sistemit përpilues dhe raportues të statistikave të sektorit jashtëm, për nevojat e Bankes së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 37,100,000 Lekë ose 296,000 Euro**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Automatizimi i sistemit përpilues dhe raportues të statistikave të sektorit jashtëm, për nevojat e Bankes së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **27 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje disa pajisje informatike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 26,542,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje disa pajisje informatike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **21 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Kontrolle në të gjitha pikat doganore

AKU bllokoi 13.3 tonë produkte të importuara jashtë standardit

TIRANË - Autoriteti Kombehtar i Ushqimit, në vijim të kontrolleve me qëllim sigurinë ushqimore të produkteve që importohen nga shtetet e tjera drejt vendit tonë ka kryer 4011 inspektime për periudhën 1-25 tetor në të gjitha pikat doganore të vendit. Mësohet se gjatë kësaj periudhe janë konstatuar dhe bllokuar 13.3 tonë produkte ushqimore të pasigurta për tregun shqiptar. Trupa inspek-

tuese e AKU-së ka kryer procedurat për kthim në origjinë të këtyre produkteve. Konkretisht, në pikën doganore Durrës janë bllokuar 4.5 tonë oriz me vend origjinë, Spanjë. Ngarkesa në fjalë nuk shoqërohej me certifikatë fitosanitare, gjë që bie në kundërshtim me legjislativonin në fuqi. Ndërkohë, në pikën doganore, Qafë-Thanë është bllokuar një sasi prej 1.8 tonë domate me vend origjinë Lituanë, pasi u konstatua prezencë myku dhe të



kalbura, pra të papërshtatshme për konsum. Ndërsa në pikën doganore Hani i Hotit janë bllokuar 2.2 tonë birra, origjina nga Çekia dhe 4.8 tonë produkte ushqimore si, kripë, salcë djathi, patatina, kokoshka dhe çokollatë me vend origjinë, Hungarinë. Këto dy ngarkesa ishin afër afatit të skadencës, pra nuk lejohen të futen për konsumin vendës.

Arrestohet një nga autorët

Sherr me thika mes disa të rinjve, plagosen dy vëllezër

CËRRIK - Dy vëllezër kanë mbetur të plagosur me thikë pas një sherrit të çastit para një supermarketi në Cërrik. Bëhet fjalë për shtetasit Eriold dhe Nexhip Balla, përkatësisht 29 dhe 26 vjeç, të cilët fatmirësisht ndodhen në spital jashtë rreziqut për jetën. Ndërkohë që pas ngjarjes, policia ka mundur të arrestojë njërin prej autorëve të dyshuar. "Me datë 26.10.2018, në qytetin e

Cërrikut, para një supermarketi, pas një konflikti të çastit mes shtetasve E.B. N.B. (vëllezër), dhe N.Ç. S.S. E.B. janë plagosur me mjet prerës (thikë) shtetasit E.B. 29 vjeç dhe N.B., 24 vjeç, banues në Elbasan, të cilët ndodhen në spitalin e Elbasanit nën kujdesin e mjekëve jashtë rreziqut për jetën. Me marrjen e njoftimit shërbimet e policisë Cërrik kanë ndërhyrë menjëherë duke arrestuar në flagrancë njërin prej au-



torëve të dyshuar e konkretisht shtetasin N.Ç., 28 vjeç. Forcat e policisë janë vënë në ndjekje të dy shtetasve të tjerë S.S. dhe E.B., të dyshuar si autorë të ngjarjes, ku vijon ndjekja për kapjen e tyre. Grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Debatet në këshillin bashkiak, socialisti Mullaraj: Do kthehet në park për fëmijët

Klodiana Haxhijaj

DURRËS

Shpallja e emergjencës mjedisore në territorin e Bashkisë së Durrësit, ku hidhen mbetjet urbane të pandara e të patrajuara, përfshirë mbetjet e rrezikshme spitalore dhe industriale, nuk ka sjellë ende asnjë ndryshim në qytetin bregdetar. Kafshët e gjalla që ushqehen me mbetjet urbane e më pas përfundojnë në tryezat e konsumatorëve janë po aty në Porto-Romano, ku u premtua se do të ndërtohet një park i gjelbëruar për banorët e zonës. Era e rëndë e dekompozimit të mbetjeve urbane të çan flegurat e hundës. Tymi toksik që çlirohet nga djegia e pakontrolluar në natyrë e plehrave shtrihet mbi zonën e banuar përreth dhe kampusin universitar e më tej drejt qytetit, i favorizuar nga era. Herë pas here banorët e zonës kanë protestuar në lidhje me ndotjen mjedisore, duke kërkuar që të ndërhyhet urgjentisht për zgjidhjen e këtij problemi, por deri tani nuk ka një zgjidhje konkrete. Nisur nga situata e krijuar, ka ngritur zërin këshilltari demokrat i Durrësit, Shkëlqim Fortuzi, njëkohësisht edhe lektor në universitetin "Aleksandër Moisiu". Gjatë mbledhjes së radhës së këshillit bashkiak të këtij qyteti që u zhvillua mbremjen e së enjtes dhe ku nuk ishte i pranishëm kryebashkiaku Vangjush Dako, ai tha se çështja e plehrave në Porto-Romano vijon të jetë gangrenë mjedisore për qytetin. "Pavarësisht se kemi tre muaj që votuam për shpalljen e emergjencës, plehurat po digjen në të njëjtin vend dhe tymi po helmon 20 mijë studentë dhe banorët e Durrësit, ky tym po del deri tek Ura e Dajlanit", - pohoi Fortuzi. Ndërkaq, kreu i këshilltarëve të Partisë Socialiste, Alfred Mullaraj përsëriti atë çfarë ka thënë

"Plehrat që digjen në Porto-Romano po helmojnë 20 mijë studentë e banorët e Durrësit"

Këshilltari i PD-së, Shkëlqim Fortuzi: Tymi i mbetjeve shkon deri tek Ura e Dajlanit

kryeministri Edi Rama kur vizitoi fushën e mbetjeve urbane në Durrës. "Porto Romano do të kthehet në një park për fëmijët dhe plehurat e Durrësit do të kenë si destinacion inceneratorin e Sharrës", u shpreh Mullaraj. Vetëm pak ditë më parë, Bashkia e Durrësit bëri me dije për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se i ka kaluar me shkresë zyrtare Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve shpalljen e emergjencës mjedisore, për shkak se bashkia nuk ka fonde. Ky komitet, i cili varet nga Kryeministria ende nuk ka marrë vendim apo nuk ka dhënë asnjë alternativë zgjidhjeje deri tani. Ndërkaq, në mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak u debatoa në lidhje me transparencën e fondeve të miratuara për rrugën "Egnatia" në qendër të Durrësit dhe zonën turistike të Shkëmbit të Kavajës nga këshilltarja e LSI-së, Edlira Hyseni dhe i PD-së, Armand Teliti. Hyseni tha se për 500 m rrugë po kërkohet të miratohet 1 milion euro fond. Ndërsa, Teliti tha se po abuzohet me prejren e pemëve dhe shtrimin e trotiareve me mermer me fondet publike. Si asnjë herë më parë, të djathtë e të majtë kanë votuar pro të 17 projektvendimet e këshillit bashkiak të Durrësit në mbledhjen ku mungonte kryetari i bashkisë, Vangjush Dako.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak të Durrësit

45-vjeçari u kap teksa po largohej nga banesa

I sëmuri me probleme mendore i vë zjarrin shtëpisë dhe mbyll brenda nënën dhe motrat

FIER - Policia e Fierit ka arrestuar autorin e dyshuar të vënies së zjarrit në një banesë në lagjen "8 Shkurti" të këtij qyteti. Mësohet se në orët e para të mëngjesit të djeshëm ka rënë zjarr në banesën e shtetas E.D., 69 vjeç. Shërbimet e policisë dhe zjarfikësja bënë të mundur nxjerrjen e familjarëve jashtë banesës dhe shuarjen e zjarrit. Nga hetimet paraprake rezultoi se zjarrin e ka vënë shtetas A.D., 45



vjeç, djali i shtetas E.D., i cili pasi ka vënë zjarrin, ka mbyllur derën e jashtme dhe po largohej nga banesa, por u konstatua dhe u kap nga

shërbimet e policisë. Dyshohet se shtetasi A.D. vuan nga probleme të shëndetit mendor. Familjarët e tjerë që ndodheshin në shtëpi, konkretisht e moshuara F.D. dhe vajzat e saj D.D., 38 vjeçe dhe B.D., 24 vjeçe, (të cilat nuk kanë pësuar dëmtime, por vetëm shenja afiksie) u dërguan në Spitalin Rajonal Fier dhe ndodhen nën kujdesin e mjekëve. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.



Zbret nga autobusi, makina përplas 11-vjeçarin

SHKODËR - Një 11-vjeçar është plagosur rëndë në një aksident të ndodhur para ditën e djeshme në aksin rrugor Shkodër-Velipojë. Mësohet se i mituri me inicialet E.R. është përplasar nga një makinë sapa ka zbritur nga autobusi. "Me datë 26.10.2018, në aksin rrugor Shkodër-Velipojë, në fshatin Berdicë e Mesme, ka ndodhur një aksident rrugor. Mjeti me targë AA 120 TS ka aksidentuar fëmijën E.R., 11 vjeç, i cili sapa kishte zbritur nga autobusi. Fëmija është dërguar në Spitalin Rajonal Shkodër dhe ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Menjëherë kanë shkuar shërbimet e policisë në vendngjarje, ku kanë bërë shoqërimin e shtetasit H.M. 31 vjeç, banues në fshatin Mushan, Shkodër, për veprime të mëtejshme. Veprimet po kryhen me grup hetimor për sqarimin e rrethanave të aksidentit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

TIRANË - Dosja "Babale" i është deleguar dje Prokurorisë së Tiranës, pasi Prokuroria e Krimeve të Rënda ka hequr dorë nga kjo çështje, me argumentin se nuk është kompetente. Çështja e kallëzimit të rremë për deputetin e Partisë Demokratike, Ervin Salianji, Albert Veliu, ose "dëshmitarin X", Fredi Alizotin dhe gazetarin Jemir Oldashi do të hetohet nga prokuroria e kriveqytetit. Duke qenë se akuzat e kallëzimit të rremë, që është



Albert Veliu

Krimet e Rënda heqin dorë nga "Babalja", dosja i delegohet Prokurorisë së Tiranës

të objekt i kësaj çështjeje nuk klasifikohet si krim i rëndë, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka shpallur moskompetencën. Organi i akuzës nisi hetimet pas publikimit të audio-përgjimit të publikuar nga Partia Demokratike, ku pretendohet se Albert Veliu fliste me vëllain e ministrit të Brendshëm për të trafikuar

drogë. Pas pesë muajsh hetim, sipas prokurorisë, zëri nuk ishte i Geron Xhafajt, por i Fredi Alizotit, mik i Veliu, i cili pranon inskenimin. Pas kësaj deputeti, Salianji publikoi një video ku Fredi Alizoti sqaronte se për të dhënë dëshminë e tij në prokurori, ishte sjellë në Tiranë nga drejtori i Policisë së Shtetit

dhe ishte joshur. Prokuroria po i heton të dyja çështjet, ndërsa mban në qeli Fredi Alizotin dhe ka bërë kërkesë për ekstradim nga Kosova për Albert Veliu. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka mbajtur vetëm fashikujt ku flitet për dyshimet mbi veprën penale të trafikut të narkotikëve.

Raporti i INSTAT: Veprat penale bien me 3.7%, një vrasje më shumë se në 2017-ën

TIRANË

Në tremujorin e tretë të këtij viti është rritur aktiviteti kriminal në fushën e drogës si dhe vjedhjeve të banesave, dyqaneve dhe lokaleve në krahasim me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa, përsa i përket numrit të vrasjeve me dashje në këtë tremujor është evidentuar një më shumë se në të njëjtin periudhë të vitit 2017-të, përfshirë muajt korrik-gusht-shtator. Të dhënat janë bërë publike nga Instituti i Statistikave në buletin e statistikave të krimeve, ku rezultoni se janë shënuar 9579 vepra penale në total me një rënie me 3.7 për qind krahasuar me vitin që shkoi.

RAPORTI I INSTAT

Në këtë raport thuhet se numri i grupveprës vrasje me dashje të evidentuara, në tremujorin e tretë 2018, është 14, një vrasje më shumë, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Për grupveprën penale vrasje mbetur në tentativë, në këtë periudhë janë evidentuar 34 vepra, 5 më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Numri i veprave penale të rënda kundër pasurisë në këtë tremujor është 29, duke shënuar një rënie me 7 vepra, krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Kjo grupveprë përfshin veprat penale vjedhje me dhunë, vjedhje me armë dhe vjedhje me pasojë vdekjeje.

Në tremujorin e tretë 2018 janë evidentuar 38 krime me natyrë seksuale, 3 më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Në tremujorin e tretë 2018 janë evidentuar 641 vepra penale në fushën e drogës, duke shënuar një rritje me 4.6 %, krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit 2017. Këtu përfshihen veprat "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Trafikimi i narkotikëve". Ndërsa, numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e tretë të këtij viti është 699, duke shënuar një rritje me 3.7%, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

Rritet numri i vjedhjeve të banesave dhe bizneseve në tremujorin e 3-të të këtij viti

Shtohet edhe aktiviteti kriminal në fushën e shitjes dhe kultivimit të narkotikëve



DROGA

Në tremujorin e tretë të 2018-ës janë evidentuar 641 vepra penale në fushën e drogës, duke shënuar një rritje me 4.6%, krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit 2017. Këtu përfshihen veprat "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Trafikimi i narkotikëve". Ndërsa, numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e tretë të këtij viti është 699, duke shënuar një rritje me 3.7%, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

periudhë janë evidentuar 13 vjedhje duke shpërdoruar detyrën, 16 vjedhje më pak krahasuar me të njëjtin tremujor të 2017. Numri i veprave penale të evidentuara për vjedhje mbetur në tentativë në tremujorin e tretë 2018 është 93,3 vepra më shumë, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Numri i veprës penale "shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", në tremujorin e tretë 2018 është 596, duke shënuar një rënie me 13.0%, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

AUTORËT E VEPRAVE PENALE

Në tremujorin e tretë 2018 janë evidentuar gjithsej 9.279 autorë të veprave penale,

duke shënuar një rënie me 4.1% krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Numri i autorëve për grupveprën vrasje me dashje, në këtë tremujor është 13, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Ndërkohë numërohen 45 autorë të evidentuar për grupveprën vrasje mbetur në tentativë, 10 autorë më pak, krahasuar me tremujorin e tretë 2017. Numri i autorëve për vepra penale të rënda kundër pasurisë, në tremujorin e tretë 2018 është 36 autorë, 10 autorë më pak, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2017. Në këtë periudhë janë evidentuar 37 autorë për grupveprën krime me natyrë

VRASJET

Numri i grupveprës vrasje me dashje të evidentuara, në tremujorin e tretë të 2018-ës është 14, një vrasje më shumë, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Për grupveprën penale vrasje mbetur në tentativë, në këtë periudhë janë evidentuar 34 vepra, 5 më pak krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Ndërkaq, numri i autorëve për grupveprën vrasje me dashje, në këtë tremujor është 13, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë janë 2 autorë më pak të evidentuar.

seksuale, e njëjta vlerë ishte edhe në tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Numri i autorëve për krime në fushën e drogës, në tremujorin e tretë 2018, është 699, duke shënuar një rritje me 3.7%, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Për veprën vjedhje e autometeve, në këtë tremujor janë evidentuar 9 autorë, 13 autorë më pak, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. Në tremujorin e tretë 2018 janë evidentuar 78 autorë për veprën vjedhje lokale tregtie, 39 autorë më pak krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Numri i autorëve për vjedhje banese, në tremujorin e tretë 2018 është 126, duke

VJEDHJET

Bastisja e bizneseve të konsideruara lokale tregtie ka pësuar një rritje me 36%, thuajse afro dyfish krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar. Edhe krimet që lidhen me vjedhjen e banesave kanë shënuar rritje me 15%, përkthyer në shifra me 321 vjedhje banesash. Ulje të veprave penale janë shënuar në qarkullimin rrugor, ku janë 596 të tilla, 13% më pak se tremujorin e 2017-ës.



Plagosi 50-vjeçarin për hasmëri, identifikohet dhe shpallet në kërkim Besnik Batusha

TIRANË - Policia e Tiranës ka mundur të zbardhë ngjarjen e rëndë që ndodhi mbrëmjen e së enjtes në Kamëz, ku mbeti i plagosur me armë zjarri 50-vjeçari Elez Bodisha. Pas hetimeve të kryera, blutë kanë identifikuar dhe shpallur në kërkim autorin e dyshuar. Bëhet fjalë për 47-vjeçarin Besnik Batusha, banues në kryeqytet. Sipas bluve, ky shtetas mbrëmjen e së enjtes, në rrugën "Nato" në Laknas, Kamëz ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit Elez Bodisha, i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Bodisha ka marrë plagë në kofshë dhe në dorë. Mësohet se ngjarja ka ndodhur për motive hasmërie, pasi vëllai i të plagosurit ka vrarë në 2014-ën dy vëllezërit e autorit. Materialet në qarkim të 47-vjeçarit u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprat penale "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërblyes dhe i municionit".

Marrë nga "Monitor"

NDERYRJA



Imazhet, si do shndërrohet Muzeu Kombëtar, nga bar-kafeja te rikonceptimi

Fatmira Nikolli

Hyrja duhet të jetë ftuese dhe transparente, ekrane digjitale, reception, dyqan suvenirësh, bar-kafe, gardërobë, forma interaktive digjitale. Këto fraza, shoqërojnë një imazh modern të Muzeut Kombëtar në atë që do të jetë ai, pas një ndërhyrjeje të ardhshme. Duke qenë se prej kohësh është diskutuar gjendja e tij, ndonëse iu nënshtrua një ndërhyrjeje me rastin e vizitës së Papa Françeskut në Tiranë, duket se kjo e dyta do ta shndërrojë atë, ndonëse deri më tani, bëhet fjalë për një shndërrim imazhi më shumë se sa për nevojat që ai ka për sisteme ajrimi e kondicionimi për ruajtjen e fondeve.

POR ÇFARË KA NDOHDUR?

Ka qenë ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro që përmes një postimi në profilin e saj zyrtar në rrjetin social 'Facebook' ka postuar disa imazhe të punës së nisur ndërkohë për rivitalizimin. Paraprakisht, shohim drejtoresha të ministrisë që bashkë me shefen e dikasterit, dëgjojnë me endje Olsi Eftimiun, arkitektin që ka punuar me ArTurbinën dhe Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit që duket të jetë pjesë e grupit të punës për një tjetër institucion kulturor, sërish kombëtar. Me gjasë, më vonë do bëhen edhe konkurset për të përgjedhur konceptet e propozimet, me gjasë po, por asgjë nuk është njoftuar zyrtarisht, po mbase do të ndodhë në të ardhmen.

Deri më tani, nga imazhet që ka bërë publike vetë ministrja, shihen fletë e shënime, vizatime e kënde, madje edhe bar e kafe, teksta flitet për Muzeun Kombëtar si një "objekt monolit me fasadë të fjetur në shesh dhe jo komunikues", për ç'arsye pas këtij teksti shohim një hyrje të gjerë me xhamia, me kënde për t'u ulur. Synohet siç lihet të kuptohet që muzeu të ketë funksione publike (?) dhe aktivizim i sheshit nëpërmjet kulturës, sepse, siç thotë parulla "një muze nuk është vetëm një fasadë". E megjithatë, nevojat janë të mëdha e domosdoshme, janë po ashtu urgjente: që nga lagështira, të përcjimi i temperaturave, atje lart në katin e ikonave, që 'ment' u ka dalë boja të këto vite nën përvëlimin e mbi 30 gradëve



Nis diskutimi për ndërhyrjen në objektin e kujtesës

në verë, e atyre të ulëta fare në dimër. Pra, Muzeu, në fakt, ka vetëm fasadën, që është ai mozaiku i madh për të cilin që bërë një debat po i madh, e që, në fakt, u la

siç qe, sepse ne shpesh ia dalim të bëhemi lëmsh, por jo ta zgjidhim lëmshin për të vënë në fill të ardhmen.

Përtej imazheve, Kumbaro sh-



kruan se "Intensifikohet puna për përgatitjen e projektit të rehabilitimit të Muzeut Historik Kombëtar, grupi i punës pasurohet me ide dhe këshilla, sfida është e madhe, por edhe angazhimi ynë, gjithashtu". Ajo falënderon anëtarët e Komitetit Shtetëror të Muzeve për sugjerimet dhe thotë se këshillimet vazhdojnë derisa të mbërrihet në projektin e duhur për të konceptuar: "Itinerare të

reja muzeore të Muzeut të ndër-tuar në vitin 1981 dhe që ende mban vullën ideologjike të regjimit duke mos iu përgjigjur më gjeneratës së shek. XXI, as teknologjisë bashkëkohore, por sidomos as konceptit të një muzeu të historisë së qytetërimit të njerëzve që kanë jetuar në këto troje, funksione të reja sociale, zbatimë dhe edukuese për hapësira të shfrytëzuara keq, e që duhet të kthehen në atraksion për publikun; projekt rikonstruksioni fizik për një ndërtesë tejet të amortizuar, të lodhur, që asnjëherë s'është investuar në strukturë, e të cilës sot i mungojnë të gjithë parametrat e kushteve të domosdoshme të një institucioni publik kulturor; ruajtje të trashëgimisë kulturore, të fondëve e koleksioneve dhe modernizim të jetës së muzeut; hapje të muzeut ndaj sheshit dhe demokratizim të ndërtesës duke ofruar multifunksione dinamike".

DITËT E KUJTESËS PROMOVOJNË BOTIMET MBI DIKTATURËN

Në ditën e pestë të edicionit të tretë të "Ditëve të Kujtesës", u promovuan botimet shkencore mbi diktaturën. Nën kujdesin e Institutit për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC) dhe bashkëpunimit me Fondacionin Konrad Adenauer (KAS), u prezantuan për publikun "Komunizmi përmes dokumenteve arkivore", vëllimi i shtatë i "Fjalorit enciklopedik të viktimave të terrorit komunist" dhe vëllimi i parë i "Indoktrinimit komunist" botime të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK) dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA).

Për "Komunizmi përmes dokumenteve arkivore", Drejtoresha e IDMC, Jonila Godole tha se Instituti që ajo drejton ka menduar të rëndësishëm botimin e një libri që përmban materiale plotësuese për lëndën e historisë në gjimnaze, sepse "ka ardhur koha që historia të mos mësohet nga thashethemet, por përmes të dhënave arkivore". Sipas saj "mësuesit duhet t'u tregojnë nxënësve

fakte të së shkuarës dhe kështu historia të tregohet ashtu sikurse ishte dhe jo sikurse bëhet aktualisht me tekste që nuk flasin qartë për diktaturën". Më tej ekspertja e kurrikulës në shkolla, Fatmiresha Xhemalaj, tha se vëllimi i dytë, ndryshe nga vëllimi i parë që flet për "Represionin në periudhën e vetizolimit", ndalet te "Jeta e përditshme në periudhën e vetizolimit". Të pranishëm në sallë ishin nxënës të shkollave të ndryshme, por edhe ish-të përndjekur. Vëllimi i enciklopedisë e prezantoi Çelo Hoxha, Drejtor i Drejtorisë së Arkivit në ISKK i cili rikujtoi se punimi ka mjaft vlera për studiuesit dhe sidomos familjet e të përndjekurve. Çelo tha se "enciklopedia e viktimave shërben njëjtë si kodikët e shumëpërfolur, pasi edhe në të ardhmen, kur të ketë kaluar kohë, emrat e atyre që vuajtën diktaturën do të mbetet". Sipas tij ekzistenca e atyre që vuajtën nuk është vetëm në listat e dëmshtëpërblimeve, sepse për shembull "klerikët nuk e kanë kërkuar dëmshtëpërlimin, po



kështu një pjesë e ish-të përndjekurve nuk kanë lënë pas njëzërë të cilët ta kërkojnë atë, dhe po ashtu ka ish-të përndjekur që nuk e kanë kërkuar fare". Kështu siç çelosi "kjo nuk do të thotë se ata nuk kanë qenë të përndjekur vetëm pse nuk figurojnë për dëmshtëpërlime".

I pranishëm në aktivitet, Drej-

tori i KAS për Shqipërinë, Walter Glos premtoi mbështetje të mëtejshme të projekteve që synojnë zbardhjen, dokumentimin dhe ruajtjen e historisë së vuajtjeve njerëzore të diktaturës. Ndërkohë prezantimin për "Indoktrinimin komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (1945-1968)" e bëri historiani Beqir Meta. Vëllimi i parë sipas tij nuk mund të përfshinte të gjitha aspektet dhe masën e përgjithshme të indoktrinimit komunist, prandaj "u vendos që të specifikohet për kulturën letërsinë dhe artin". Indoktrinimi ka qenë një proces shumë i suksesshëm për diktaturën, ndërsa për ne shqiptarët, ka qenë një proces që fatkeqësisht i deformoi shumë aspekte të jetës së përditshme, të sjelljeve apo dhe gjykimit" – tha Meta, i cili kujtoi të ashtuquajturat shpërthime të kulturës, që në kohën e komunizmit drejtoreshin nga persona që nuk kishin aspak formim dhe mund të cilësoheshin edhe analfabete.

BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 633

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 27 Tetor 2018

KRISJA E ÇIFTIT



**FLIRTOI ME VAJZEN NE KLUB,
NDAHET ÇILJETA ME ALBAN HOXHEN?**

**Upss! Rita
Orës i dalin
të brendshmet
gjatë
perfomancës
'live'**



KENGETARJA



**KLODIANA VATA:
PARA NJË VITI
S'MË PRANUAN**

*"Në Shqipëri më shumë
shet imazhi se zëri"*

BËN AKSIDENT, REPERI I NJOHUR NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE




Bën aksident, reperi i njohur në gjendje të rëndë shëndetësore

E dhe pse kohët e fundit nuk është shfaqur shpesh në media, ai është një nga reperat më të lakuar në botën e muzikës. Së fundmi, Cozman ka postuar një foto i shtrirë në spital dhe nuk ka treguar ndonjë detaj për sëmundjen. Ai duket se ka probleme me shëndetin. Ndërkaq, postimi duket se është i shtrirë në spital, ndërsa nuk ka treguar se çfarë probleme ka. Megjithatë, Cozman ka shkruar thjesht: "Jam rikthyer", duke lënë të kuptohet se nuk është hera e parë që atij i duhet një ndërhyrje në shëndet. Urojmë të bëhet mirë së shpejti!



Sa surprizë romantike! Moderatorja shqiptare i bën dhuratën më të bukur të dashurit

Vetëm para pak ditësh, ata bënë publike lidhjen e tyre, ose më saktë e pranuan që ishin në një lidhje, edhe pse tashmë kanë kaluar 2 vite bashkë. Po flasim pikërisht për Fatma Methasanin dhe Alfio Rrotanin, për të cilët thuhet se janë njohur në ambientet e televizionit "INTV", ku edhe punonin të dy. Ditën e enjte Alfio kishte ditëlindjen dhe surprizën më të madhe ia ka bërë e dashura me dhuratën e zgjedhur për të. Fatma e ka zbuluar këtë me anë të një fotoje që ka publikuar në "Instastory", ku shkruan "U zbulua edhe surpriza!", ku bëhej fjalë pikërisht për një motor. Dhe ishte mëse e pritshme që një gëzim të tillë ta ndajë edhe Alfio në "Instagram"-in e tij, i cili shkruan krahas fotos: "S'kam faj unë që të thërras drita e syve të mi! Të dua!". Vërtet çift shumë i veçantë.



Upss! Rita Orës i dalin të brendshmet gjatë performancës 'live'

Padyshim që mund të themi me plot gojë se ajo është një nga këngëtarët që na ka bërë më krenarë në gjithë botën. Por, përveç çmimeve dhe




vlerësimeve të ndryshme, Rita Ora nuk u shpëton as skandaleve. Këngëtarja ka performuar në natën 'live' të "X Factor" në Milano të Italisë. E veshur me një fustan shkëlqyes e



ngjyrë mjaft të bukur, Rita megjithatë nuk ka arritur të kujdeset që të mos i dalin të brendshmet. Ajo ka zbuluar edhe gjoksin e saj, ndërsa në flokët natyrale e të shkurtuara, Rita është dukur e mrekullueshme, joshëse dhe seksi. Skandale të tilla nuk kanë se si të mungojnë për një shpirt rebel si Rita Ora apo jo?

"Është diçka e ulët dhe e mërzitshme!", Lori Hoxha s'ia përton me përgjigjen ndjekësit

Ajo është një ndër personazhet më të ndjekur në "Instagram", e cila shquhet për jetën e saj luksoze dhe zgjedhjet gjithnjë të trendeve të fundit. Lori Hoxha, trashëgimtarja e "Top Channel", publikon shpesh në rrjetet sociale foto të restoranteve apo ushqimeve që konsumon. Ajo ndodhet në Londër kohët e fundit ku nuk ka humbur rastin të publikojë ushqime nga më të ndryshmet. Por, përveç atyre që ua bëjnë me sy ushqimet që ajo konsumon, ka edhe kritikë. "Të lutem mos! Nuk e di, por mendoj të postosh ushqim është diçka shumë e ulët dhe budallaqe (dhe shumë e mërzitshme). Në vend të tij mund të postosh disa veshje të bukura", - shkruan një nga ndjekësit e saj. Por Lori duket se nuk e ka lënë me kaq. Ajo e ka publikuar këtë koment dhe krahas tij ka shkruar: "Mua personalisht më pëlqen të di ku hanë njerëzit dhe çfarë është e mirë në një qytet të caktuar, por nuk e di. Çfarë mendoni ju?", përfundon ajo me përgjigjen për ndjekësin e saj. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, duke qenë se nuk është e vetmja që ndjek një stil të tillë të postimeve.





“E kafshoi lehtë në faqe teksa kërcenin”, ja faktet e “krisjes”

Pamela Aliaj

Ata janë një ndër çiftet më të komentuar të “show biz”-it shqiptar. Edhe pse shumë prej VIP-ave e dinë lidhjen e tyre dhe shumë shpesh janë kapur “mat” së bashku nëpër vende të ndryshme, asnjëherë nuk kanë dashur ta pranojnë publikisht dhe të flasin për lidhjen e tyre. Ndërkaq, ky vit ka qenë më intensiv për çiftin duke qenë se për një arsye apo për një tjetër ata kanë pasur shumë ulje-ngritje në lidhjen e tyre. Në fillim të vitit, në mars, u përfol për një ndarje të mundshme të Çiljeta Xhilagës me portierin e njohur të Kombëtares, Alban Hoxha. Pak muaj më parë, ai u përfol për një tradhti me një punonjëse të jetës së natës. Ishte Çiljeta, ajo që publikoi videon krah tij, duke përgënjeshtuar zërat për ndarje. Ndërkaq, vera kaloi shumë bukur për çiftin ku nuk munguan postime fotosh e videosh nga ana e Çilit, duke shfaqur momente të veçanta të të dyve. Gjithçka po shkonte vaj deri para pak ditësh, kur një video po qarkullonte nëpër media duke ngritur dyshime të forta se kapiteni i Partizanit, Alban Hoxha po tradhton këngëtarën Çiljeta Xhilaga. Ai është filmuar teksa po puth një tjetër vajzë në një klub nate. Hoxha shfaqet në video krah një vajze të panjohur, shumë ekstravagante, të veshur me reçipeta, duke e kafshuar. Sportisti është filmuar në njërin prej klubeve më të frekuentuar të kryeqytetit, teksa flirtonte me një vajzë misterioze. “Përsëritet, unë e njoh atë va-


Flirtoi me vajzën në klub, ndahet Çiljeta me Alban Hoxhën?

Postohet video e futbollistit me një vajzë misterioze, ç’po ndodh me çiftin



jzën, e ka emrin E**** dhe Albani e kafshoi lehtë në faqe. Ishin tek A****, - ka shkruar vajza që ka parë skenën në videon e dërguar tek “JOQ”. Çifti e ka pranuar që janë bashkë, ndërsa kjo nuk është hera e parë që vihet në dyshim

marrëdhënia e tyre. Nuk dihet si do të shkojë marrëdhënia e tyre pas publikimit të kësaj videoje, por mbeten për t'u parë reagimet e të dyve. Ndërkohë, kujtojmë që jo më larg se fillimi i këtij muaji ishte vetë Çiljeta, e cila postoi një foto tepër romantike të të dyve në faqen e saj në “Instastory”. Dy duar të bashkuara. Pra, pas kësaj tradhtie s'kishte se si çifti të vijonte të ishin bashkë. Nga ana tjetër vërejmë se



në faqet e tyre në “Instagram” këngëtarja nuk është duke e ndjekur futbollistin dhe as ai atë, ndërkohë që ky i fundit ka hequr edhe foton e profilit. Shumë shenja dhe asnjë reagim prej çiftit. Të jetë kjo një “ndarje” në heshtje?



Rikthehet në skenën e muzikës, flet këngëtarja: “Eurovizioni”, ëndrra ime e madhe

Vjen me “Mbrëmje e Pafund”,

Klodiana Vata:

Para një viti s’më pranuan

“Në Shqipëri më shumë shet imazhi se zëri”

Kanë filluar përgatitjet për një nga eventet më të përfolura dhe të dashura për publikun shqiptar, që na përfaqëson edhe jashtë kufijve. Së shpejti do të nisë festivali i 57-të i këngës në RTSH dhe jo të paktë janë konkurrentët, të cilët kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre. Një ndër ta është edhe këngëtarja e talentuar, Klodiana Vata. Vajza nga Shkoder, me një zë unik, e ka ëndërr “Eurovizionin” dhe një përfaqësim i denjë i saj në këtë event është dhe shkaku i pjesëmarrjes këtë vit. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Vata na rrëfen të pathënat e këngës dhe realizimit të saj. Talenti i cili rrëmbeu zemrën e Francës në moshë më të re vjen sërish me një baladë të realizuar nga figurat më të njohura të muzikës shqiptare. Ndërkaq, Klodiana na ka folur edhe për projektet e saj jashtë vendit, si dhe aspiratat për të “pushtuar” Parisin. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Pamela Aliaj

Këtë vit do të merrni pjesë në festivalin e 57-të të RTSH. Është hera e parë që konkurroni në një event të tillë. Si lindi ideja?

Ideja më ka lindur që vitin e kaluar, pasi konkurrova me kënge, e cila nuk u pranua. Për këtë vit ishte fati im që kompozitori i njohur Edmond Zhulali më zgjodhi mua për t’i kënduar këngën në Festivalin e Këngës.


Cila është kënga me të cilën do të përfaqësoheni në festival? Baladë apo...?

Kënga titullohet “Mbrëmje e Pafund” dhe është këngë rit-



Voix de la Scène”, a keni pasur oferta nga shtëpi muzikore?

Ofertat kanë qenë të shumta, por duke qenë se këto lloj bashkëpunimesh kanë kërkuar që unë të le përgjysmë studimet dhe të zhvendosem jashtë vendit, jam detyruar që për momentin të heq dorë prej tyre dhe t’i shoh si opsion për më vonë.



mike.

A keni pasur muzë për këtë këngë? Ju frymëzoi, diçka apo dikush?

Ideja ishte e kompozitorit, pasi që në momentin e krijimit ishte menduar si e tillë. Pastaj u bashkëpunua edhe me tekstshkruesin, Jorgo Papingji, i cili punoi për një tekst, i

cili u vesh më së miri kësaj kënge.

Projekti juaj i fundit është “Shi lodre”. A keni pasur reagime nga të huaj në vlerësimin e kësaj kënge, përveçse shqiptare?

Reagimet pozitive dhe të shumta kanë qenë si në mediat shqiptare, në Kosovë,

Maqedoni etj. Një nga kolegët e mi më është shprehur se rastësisht kishte dëgjuar këngën time teksa transmetohej në një kanal televiziv në Finlandë.

Pas suksesit të disa kohëve më parë në Francë lidhur me fitoren e çmimit të parë në konkursin “Les

Cili është projekti me të cilin është duke u marrë Klodiana së fundmi përpos këngës së festivalit të RTSH?

Po punoj për një këngë të re, të cilën do ta publikoj së shpejti.

Pse pikërisht këtë lloj konkurrimi dhe jo "Kënga Magjike"?

Ky lloj bashkëpunimi, sepse unë edhe disa vite më parë kam qenë konkurrenente në "Junior Eurovision" dhe e kam ëndërr që një ditë të jem përfaqësuese e Shqipërisë në "Eurovision".

A keni pasur raste kur nuk jeni ndjerë e vlerësuar mjaftueshëm apo edhe e penalizuar?

Shumë herë, pasi është një rrugë shumë e vështirë dhe plot sfida.

Përveçse pasionit të muzikës, cili është profesioni që jeni duke ndjekur?

Për momentin jam duke drejtuar një emision në Radio "Shkodra", eksperiencë të cilën e ushtrroj prej 3 vitesh pa lënë mënjane edhe moderimin, pasi jam moderatore edhe në disa evente. Event i radhës ku do të moderoj është Festivali Ballkanik për fëmijë, që zhvillohet në Shkup të Maqedonisë.


Muzikën e shihni si pasion që duhet mbajtur gjallë dhe që ju identifikon apo thjesht një fazë e jetës suaj e cila mund të përfundojë në një moment të caktuar?

Muzika për mua është gjithçka.

A keni menduar të jetoni jashtë vendit dhe të nisni karrierën tuaj andej? Nëse po, ku dhe pse?

Po, e kam menduar dhe vendi që synoj është Parisi.

Së fundmi, nëse do t'ju



jepej mundësia të bënit një duet me një këngëtar/ e të njohur, cila/i do ishte ai/ajo?

Nuk është se e kam menduar të bëj ndonjë bashkëpunim, por as përjashtuar këtë mundësi.


Ç'mendim ka Klodiana lidhur me tregun e sotshëm muzikor? Më tepër shet "imazhi" apo

zëri?

Në Shqipëri fatkeqësisht ndodh kjo që më shumë shet imazhi se zëri. Uroj që një ditë kjo gjë të ndryshojë.

A do të guxonit të dilnit nga stili juaj për pak më shumë famë si këngëtarët e tjerë?

Tani për tani nuk e mendoj dhe besoj që as në të ardhmen nuk do të ndodhë.



Nuk i ndahet shpirti nga "Portokalli", rikthehet aktori i humorit nga SHBA

Surpriza të tjera pritet të shfaqen në 'show'-n humoristik "Portokalli". Këtë të diel, aktori i njohur i humorit, Erand Sojli do t'i rikthehet skenës. Në një intervistë për "Top Channel", ai zbuloi se është shumë i emocionuar për këtë fakt. Pavarësisht se jeton në Amerikë, asgjë nuk e ka ndaluar aktorin e njohur që të rikthehet për publikun shqiptar. "Unë jetoj në Amerikë dhe vij për të punuar në 'Portokalli', sepse nuk më ndahet shpirti nga ky spektakël. E kam nisur këtu dhe e ndjej se duhet të jap kontributin në mënyrë që të ketë shkëlqimin e gjithanshëm. Unë dua të ndjej edhe njëherë dashurinë e madhe të publikut në këtë spektakël, i cili është më i shikuari nga komuniteti shqiptar në Amerikë, ku unë jetoj dhe ushroj profesionin tim si artist", -shprehet Erand Sojli për "Top Channel". I pyetur për jetën e re në Amerikë, Erandi tregon se i është përkushtuar interesit të shqiptarëve të Amerikës, duke rizgjuar interesin për teatrin dhe aktrimin. "Jam shumë i emocionuar që kjo e diel do më gjejë si e diela e shumë viteve më parë, me të njëjtat emocione dhe të njëjtin angazhim ndaj spektatorëve", - tha Sojli.



S'na e priste mendja! Reperi shqiptar zbulon të dashurën super bombë

Ai është një nga reperët më të rinj në tregun muzikor. Edhe pse në një moshë fare të re dhe me vetëm pak muaj karriere si reper, ai është kthyer në një prej këngëtarëve më të dashur për publikun adoleshent. Po flasim pikërisht për Fero Ferën, i cili së fundmi na ka njohur me të dashurën e tij. Ajo quhet Arbenita Ismajli dhe mund të themi me plot gojë se është një super bombë. Bukuroshja, e cila merret me modeling duket se i ka vjedhur zemrën reperit Fero. Dyshimet kanë lindur pasi modelja dhe këngëtari komentonin në fotot e tyre në "Instagram", duke lënë të kuptohet që mes tyre ka më shumë se miqësi. Megjithatë, ende asgjë nuk është komentuar nga çifti. Të shohim në komentet e radhës, para se t'i kapë paparaci.



Një yll tjetër shqiptar do na bëjë krenarë, ja kush do "zërë vendin" e Duas dhe Ritës

Tashmë kemi prej disa vitesh që në tregun botëror muzikor disa këngëtare janë duke na bërë krenarë. Po flasim pikërisht për Rita Orën, Dua Lipën, Era Istrefin, Stanaj si dhe Bebe Rexhën. Por mesa duket, do të lindë një tjetër yll shqiptar që do të konkurrojë pranë tyre. Me dy bashkëpunime me D.J e famshëm David Guetta, 25-vjeçarja me origjinë nga Kosova, e cila quhet Amanda Ava Koçi ka arritur që këngët e saj të klasifikohen në krye të top-listave muzikore në Europë edhe më gjerë. Emri i saj i artit është Ava Max dhe së fundmi bukuroshja ka publikuar këngën e re në bashkëpunim me Jason Derulo, që pritet të kthehet shumë shpejt në një superhit.



Lum si Marina! Getoari i bën dedikimin që askujt s'ia merrete mendja

Të gjithë e kemi parë sa i dashur dhe romantik është ai me Marinën. Mund të themi se Getoari është partneri perfekt jo vetëm në detaje, por edhe në vëmendjen që i jep bashkëshortes së tij. Reperi jo vetëm që përkëdhel me udhëtime në destinacione të veçanta bashkëshorten e tij, por edhe zgjedh me kujdes fjalët që i dedikon asaj. Së fundmi Getoari ka publikuar një foto të ëmbël ku shfaqet së bashku me Marinën. Në foton duket që reperi puth të shoqen në ballë, ndërkohë që përshkruan foton si "ana ime e bukur". Nga ana tjetër, Marina Vjollca mahnit me portretin e saj pa 'make up', ku shfaqet duke buzëqeshur në krahët e partnerit të saj. Eh, dashuria të bën të lumtur!



Një tjetër dërgesë e dyshimtë i shkon ish-drejtorit të CIA

Pako-bomba te kundërshtarët e Trump, arrestohet një i dyshuar

Një person është arrestuar nga autoritetet amerikane si i dyshuar për pakot bombë që u janë dërguar figurave publike në vend. CNN raporton se i dyshuari u ar-

restua nga autoritetet federale, ndërsa identiteti nuk është bërë i ditur. Dje u gjet një tjetër pako e dyshimtë në Manhattan. Ajo ishte dërgesë postare në adresë të

ish-drejtorit të Inteligjencës Kombëtare James Clapper. Gjatë ditëve të fundit, janë gjetur 12 pako të dyshimta që u janë dërguar 10 personaliteteve në SHBA. Në mes-

in e tyre janë miliarderi George Soros, ish-Presidenti Barack Obama, ish-Presidenti Bill e bashkëshortja e tij Hillary Clinton, ish-zv/Presidenti Joe Biden, aktori Robert de Niro etj. Edhe zyrave qendrore të CNN iu dërgua një pako me material shpërthyes. Shpëtim e Bardhë i dënoi këto ngjarje duke i cilësuar sulme të dhunshme.

Hetime të specializuara edhe për 9 zyrtarë, mes të cilëve edhe 1 shqiptar

Gjykata vendos: Gruevski në burg për abuzim me fondet

Ish-kryeministri më 8 nëntor duhet të vuajë dënimin

Nikolla Gruevski do të bëjë dy vjet burg. Vendimi u mor nga Gjykata e Apelit në Shkup, e cila la në fuqi dënimin e dhënë nga Gjykatës Themelore, e cila thotë se deri më 8 nëntor ai duhet të kthehet në burg. Ish-kryeministri është shpallur fajtor për rastin "Tanku" që ka bërë me keqpërdorimet për blerjen e një makine të llojit Mercedes për afër 600 mijë euro. Për të njëjtën vepër me 4 vjet e gjysmë burgim është dënuar edhe ndihmës-ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski ndërsa një proces i veçantë po zhvillohet edhe ndaj ish-ministres, Gordana Jankulovska. Nikolla Gruevski, e ka quajtur dënimin e tij dhe të gjithë procesin të montuar politikisht. Ai ka drejtuar qeverinë e Maqedonisë për 10 vjet, si dhe partinë opozitare VMRO-DPMNE.

RASTI

Në vitin 2011, MPB-ja kishte vendosur të blejë një makinë të blinduar deri më 243 mijë euro. Por, me insistim të ish-kryeministrit, Nikolla Gruevski, ministrja Jankulovska kishte nënshkruar vendimin për blerjen e një makine tjetër, të pajisur sipas shijeve të Gruevskit, vlera e të cilës kishte arritur në mbi gjysmë milioni euro. Shpërdorimet janë zbuluar nga afëra e përgjimeve telefonike të publikuar nga LSDM-ja, e cila atë kohë ishte në opozitë. Procesin gjyqësor e ka udhëhequr Prokuroria Speciale, e formuar për hetimin e shpërdorimit të detyrës së qeverisë së kaluar. Ndërkaq Prokuroria Speciale e Maqedonisë ka nisur edhe një hetim të ri për shpërdorim të detyrës zyrtare nga ish-zyrtarët e mëparshëm. Për pastrim parash dhe dëmtim të buxhetit të shtetit prej 5 milionë euro, po hetohen ish kryeministri Lubco Georgievski, së bashku me 9 ish-zyrtarë të tjerë ku bënë pjesë edhe ish-kryeministri tjetër Nikolla Gruevski, i cili në atë kohë ishte ministër i financave. Bëhet fjalë për vitin 2001 kur të dyshuarit janë

përfshirë në privatizimin e Bankës Postare. Ish-kryeministri Georgievski ka hedhur poshtë pretendimet e Speciales duke theksuar se nuk njih asnjë nga të dyshuarit e tjerë dhe se pretendimet bazohen në një bisedë telefonike, por se njëri nga pjesëmarrësit në këtë bisedë ka ndryshuar të paktën tre herë deklaratën në prokurori. Georgievski mund të mos paditet pasi vepra konsiderohet si e vjetruar. Hetime kanë nisur dhe ndaj zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, për keqpërdorim të detyrës kush ishte ministër i Shëndetësisë në



Nikolla Gruevski

qeverisjen e BDI-në me VMRO-së ka dorëzuar në prokurori fakte me të cilat, siç tha, "dëshmohej pafajësia e tij". "Sipas meje, ky rast

është qartësuar dhe së shpejti pres edhe të mbyllet. Nga ana e përfaqësuesve të Prokurorisë Speciale, mora sigurinë dhe qasjen

pozitive se materialet e marra paraqesin kontribut të rëndësishëm për hetimin, dhe fitova bindjen se, në një afat të përshat-

shëm kohor, hetimi do të rrumbullakohet, me çka, unë jam i bindur se do të konfirmohet, se nuk ka asnjë punë të paligjshme, dhe se kjo do të ndihmojë që përfundimisht të ndërpritet të gjitha spekulimet që u shfaqën në publik, që para se të fillonte hetimi", ka deklaruar më parë ai. Osmani po hetohet për keqpërdorim në rastin e një tenderi për investimet në spitalet e vendit. Sipas Prokurorisë Speciale Publike, në këtë rast, por edhe në pesë të tjera të akuzuarit dyshohet se kanë dëmtuar buxhetin e shtetit me rreth 80 milionë euro.

TERMETE TE FRIKSHME NE GREQI, RREZIK CUNAMI

Lëvizjet e tokës tmerrojnë Greqinë. Mëngjesin e së premtes një tërmet 6.8 ballë goditi ishullin grek të Zakynthos ndërsa rreth orës 15.11 një tjetër tërmet tronditi Lamian. Epiqendra e tij ishte rreth 5 kilometra në verilindje të qytetit dhe dridhjet sizmike u ndjenë deri në Selanik. Megjithatë tërmeti i ndodhur në Zakynthos ishte i frikshëm. Për fat të mirë nuk raportohen viktima, por vetëm të lënduar e shtëpi dhe rrugë të dëmtuara keqazi. Tërmeti i fuqishëm u ndie edhe në Shqipëri e Itali. Epiqendra ishte në detin Jon, rreth 130 kilometra në jugperëndim të Patras në Peloponez. Alarmi është përhapur edhe në rrjetet sociale, ku qytetarët shprehen se kanë kaluar një natë të frikshme. Gjatë mesnatës, lëkundje u ndjenë edhe në Tiranë, në orën 00:57. Ndërkohë Institutit Kombëtar i Sizmologjisë në Itali tha se "lëkundja e tërmetit ka shkaktuar një lëvizje anormale prej 10 centimetra të detit Jon në provincën e Krotones, me rrezikun e një cunami".



Opinion i Ditës

Dialog, gjeopolitikë dhe përplasje interesash SHBA-Rusi

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... po mbush me shpejtësi përmbytjen e saj dhe që afekton e do të afektojë në proces sjelljen e qëndrimit e tyre ndaj zhvillimeve të rëndësishme në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, sidomos sa i përket sigurisë e stabilitetit të rendit botëror. Befasia e madhe e parë ishte bërja publike nga presidenti amerikan Trump e principit „America First” dhe pas saj ishte njoftimi për një takim jashtë vendeve të tyre, të presidentit amerikan Trump dhe presidentit të Rusisë Putin. U vlerësua shumë rruga apo metoda e dialogut, por thatë-sira e informacionit dhe mungesa e ndonjë zhvillimi domethënës të mëtejshëm, u kanë hapur rrugë shumë hamëndësive. Ishte një bluf për interesa konkrete, një veprim për të tërhequr vëmendjen, një tatum pulsua apo njohje nga afër të objektivave mes tyre, kjo akoma nuk është saktë-suar edhe pse analistë të ndryshëm nuk kanë nguruar me opinionet e tyre. Gjithsesi, përmbytja e marrëdhënieve mes SHBA dhe Rusisë, po mbushet me shpejtësi me përbërës thelbësorë, që po tërheqin vëmendjen, sepse po e identifikojnë me shumë ndarjet në qëndrimet gjeostrategjike, apo ndryshimin e disa gurëve apo elementëve të rëndësishëm, sidomos ndaj dakordësimeve të arritura në marrëveshje e traktate të rëndësishme për stabilitetin e sigurinë e rendit botëror, të nënshkruara më parë.

Pas rrëzimit të komunizmit dhe shpërbërjes së BRSS, u krijua një realitet i ri konkret ekonomik e politik i Rusisë, ku Jelcin ka kontributin e tij edhe pse interesat nacionaliste të zhvilluara historikisht, nuk mund të pajtoheshin kurrësi me vendin dhe rolin që mori Rusia. Një ndryshim i vërtetë mori udhë, kur në krye të interesave nacionaliste ruse u vendos Putin, i cili realisht ka meritën konkrete të sendërtimit të një strategjie të plotë e komplekse, për të mundësuar një vend e rol tjetër të Rusisë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, një rol domethënës të saj në zhvillimet botërore dhe po kështu një marrëdhënie krejt tjetër, nga ajo që formësoi Jelcin, me aktorët e rëndësishëm ndërkombëtarë, sidomos me SHBA dhe Perëndimin. Fillori shpejt të flitej edhe për një „putinizëm”, që me sa duket, Putin e frenoi të zhvillohej hapur nga brenda Rusisë. Putin mendoj më shumë të vepronte, të bënte ato që nevojiteshin, duke e ditur mbështetjen e nacionalizmit rus, që kishte peshë të madhe, jo



vetëm në klasën politike, por në mbarë shoqërinë ruse. Dhe tash Rusia është një aktor i rëndësishëm në zhvillimet botërore. Putin edhe kur bënte konstruktivën në ecurinë e asaj marrëdhënieje, në atë që u njoh si partneriteti NATO-Rusi, edhe kur shprehte kundërshtimet, me zë jo shumë të lartë, për arkitekturën e sigurisë europiane, edhe kur shfaqte mosdakordësinë e vendosjes së sistemeve raketore mbrojtëse të NATO-s në disa vende europiane, që synonin përballimin e mundshëm ndaj goditjeve të sigurisë europiane e perëndimore, nga goditje të mundshme terroriste, lëshonte ndonjë zë, ndaj lëvizjeve të NATO-s, në forcimin e sigurisë së anëtarëve të saj, se dukeshin si prirje të NATO për atë që quhej një „rrethim” ndaj Rusisë, punonte me intensitet për përgatitjen e standardeve të domosdoshme, që mundësonin një status krejt tjetër, pikërisht të superfuqisë botërore.

Putini në proces, me qëndrimet e deklarimet publike herë pas here, po tregonte ambicione reale, objektivat gjeostrategjike, sa i përket statusit, vendit dhe rolit të Rusisë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Deklarimet e tipit se, shpërbërja e BRSS ishte katastrofë më e madhe gjeopolitike, krijimi i dy organizmave ekonomike e ushtarake euro-aziatikë, me vende ish-pjesë e BRSS, por me anëtarësim në të dhe të Kinës, madje dhe me një status vëzhguesi në CSTO edhe të Ser-

bisë, strategjia e konflikteve të ngrira, me krizën gjeorgjiane, aneksimin e Krimesë e shpërthimin e konfliktit në Ukrainë, ishin tregues të qartë, se Putini synonte një rivalitet dhe ndarje roli me SHBA në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Rusia në proces e ngriti zërin e kundërshtimit ndaj plotësimit të kërkesave të Gjeorgjisë e Ukrainës, për anëtarësim në BE e në NATO dhe me vendosmëri zhvilloi strategjinë e zhvillimit të potencialeve ushtarake, të përsosjes teknologjike në zhvillimin e arsenalit ushtarak, që mundësuan edhe stërvitje ushtarake me përmasa gjithnjë e më të mëdha, siç ishte dhe kjo e fundit, së bashku me Kinën. Këto fakte dëshmojnë, se një strategji konkrete, ishte ndërtuar e u synua të realizohej. Pjesë e demonstrimit të fuqisë ushtarake dhe e interesave gjeostrategjike të superfuqisë botërore e të rivalitetit me SHBA, ishte dhe ndërhyrja e Rusisë në krizën komplekse e të vështirë siriane. Rusia kështu, bëri fakt një rol të saj në zhvillimet botërore, ku është pritur e pritë realisht një rol konstruktiv në forcimin e stabilitetit, sigurisë e paqes në botë. Tash Rusia po kalon në një stad tjetër për ta pasuruar rolin e saj në udhëheqjen botërore, ku natyrisht gjen SHBA dhe Perëndimin edhe pse tash të grindur mes vetes, që kanë kontribuar maksimalisht për stabilitetin e rendit botëror, veçanërisht pas rrëzimit të komunizmit, ku SHBA ka qenë superfuqia e vetme. Tash duket se

mund të ketë më pak dialog e më shumë veprim e hap konkret ndryshues, madje ka prirje, lëndë edhe për një retorikë në zhvillim, që ka brenda një përplasje reale interesash mes SHBA dhe Rusisë. Dhe, në fakt, një marrëdhënie kontraktore mes SHBA dhe Rusisë po e mbush me shpejtësi përmbytjen e saj. Putini është i qartë kur pohon, në një forum në Soci, se presidenti amerikan Trump ka pasur gatishmëri për të përmirësuar marrëdhëniet SHBA-Rusi, pavarësisht situatës së komplikuar në politikën e brendshme të SHBA. Madje ai e konkretizon këtë ide duke nënvizuar se Trump, jo vetëm dëshiron, por dhe mendon të stabilizojë marrëdhëniet e tensionuara mes Moskës dhe Uashingtonit. Unë, thekson Putin, kam dialog plotësisht normal dhe profesional dhe ai natyrisht më dëgjon. E shoh që ai reagon ndaj argumenteve të mija. Putin e vlerëson normalitetin, që ata të mos pajtohen për shumë gjëra. Dhe vërtet realiteti po dëshmon këtë cilësi marrëdhënieje, ku në përmbytjen e saj ka dhe diversitetë qëndrimesh e veprimesh, por dhe kontradikta e qëndrime të kundërta, por edhe tensione.

Megjithatë, zhvillimet më të fundit, tregojnë për një problematikë përplasjesh, qëndrimesh të kundërta, akuzash komplekse apo një retorikë të nxehtë. Përveç akuzës së njohur, që është në investim, për ndërhyrje të Rusisë në zgjedhjet presidenciale të SHBA, agjencitë amerikane të zbulimit e zbatimit të ligjit, kanë

shprehur shqetësimin, se Rusia vazhdon të ketë në shënjestër zgjedhjet e ardhshme për në Kongres. Madje bëhet e ditur dhe një dëshmi, që lidhet me akuzat e reja kundër një shtetase ruse Elena Khuzjanova, të lidhur me oligarkun rus, i njohur si „Kuzhinieri i Putinit”, që akuzohet për ndërhyrje në zgjedhjet e vitit 2018. Ajo akuzohet, se po punon me një buxhet miliona dollarësh, për të krijuar llogari të rreme në platforma si „Facebook” dhe „Twitter”, që mendohet se vijjnë nga biznesmeni Jevgeni Prigozhin, që ka lidhje të ngushta me institucionet politike e ushtarake të Rusisë. Po kështu, shumë analistë ngrënë shqetësimin për synime të Rusisë, në drejtim të thellimit të grindjes brenda perëndimit e BE, për të ndarë Europën apo, siç ka deklaruar Kancelarja Merkel, se Rusia kërkon të shpërbëjë BE. Analistët eidentifikojnë këtu, jo vetëm mbështetjen ndaj lëvizjeve e partive nacionaliste e populiste, të linjave ideologjike e politike të tyre anti-BE, por flasin për interesa konkrete imperiale të Rusisë dhe për një luftë hibride të Rusisë ndaj hapësirës europiane. Në këtë kuadër, ka tërhequr vëmendjen dhe përpjekja e fundit e Rusisë, që të justifikuar disa veprime, si aneksimi i Krimesë e shpërthimi i konfliktit në Ukrainë, ku Perëndimi ka akuzuar Rusinë për shkelje të ligjit ndërkombëtar dhe ndryshim me dhunë të kufijve të Europës, duke adresuar dhe sanksione ndaj Rusisë. Nëse Perëndimi e kualifikon aneksimin Krimesë, Putini e konsideron atë, jo si grabitje tokash e popujsh me dhunë, por si një demonstrim të vullnetit të popullit të Krimesë, në një referendum ku mbi 90% e qytetarëve janë shprehur për t'u shkëputur nga integriteti territorial i Ukrainës dhe për t'u bashkuar Rusisë. Rasti Krimea mund të hapë një rrugë të rrezikshme destabiliteti, apo të një rrugë të përdorimit apo të shpërdorimit të demokracisë, të keqpërdorimit të referendumëve në funksion të ambicieve gjeopolitike.

Një problem, që po bëhet i imprenhtë në marrëdhënitë mes SHBA dhe Rusisë, lidhet me atë që njihet si sulme apo lufta kibernetike, që tash kualifikohet si agresion nga Rusia ndaj vendeve perëndimore. Tani konstatohet nga një intensifikim i luftës kibernetike, të paktën që nga viti 2007 kur Estonia pësoi një valë sulmesh kibernetike, që u shfaq më pas në zhvillimin e krizës gjeorgjiane në vitin 2008. Madje tani në Perëndim flitet për një strategji konkrete jo spontane, po edhe si agresion kibernetik. Shefi i shërbimeve sekrete të Zvicrës shpreh shqetësimin për rritjen e aktivitetëve të shërbimeve sekrete ruse në Zvicër. Si →

TRAJNERI I KAMZËS

Klodian Duro do të vishet sot përballë Tiranës, një klub ku ai ka kaluar një pjesë të mirë të karrierës dhe të cilin e kujton me shumë nostalgji, ndonëse nesër do të duhet ta mundë me Kamzën e tij. "Pjesën më të madhe të karrierës time këtu e kam zhvilluar te Tirana. Janë plot 6 kampionate atje, se pjesën më të madhe të karrierës time, në fakt, e kam zhvilluar



Duro: Tirana më ka dhënë shumë, por e mund me Kamzën

jashtë Shqipërisë. I kam dhënë shumë Tiranës, por edhe kam marrë shumë prej saj. Jam në vendin e parë në historinë e Tiranës sa i përket lojtarëve që kanë veshur fanellën e kombëtares ndërsa luanin në atë klub. Por tani Tiranën do ta pres si

kundërshtar dhe dua ta mund. Do të jem shumë i kënaqur që Kamzën ta kthej te fitorja kundër saj", u shpreh trajneri në konferencën e sotme për shtyp. Megjithatë, Kamza nuk vjen në këtë ndeshje në momentin më të mirë të saj, si pa-

sojë e rezultateve jo shumë bindëse si dhe vendimit të klubit për të pezulluar disa lojtarë. "Nuk po kalojmë një periudhë si do të dëshironim, si ndodh në çdo klub profesionist futbolli. Klubi ynë ka rregullat e veta dhe klubi ka marrë masën e pezullimit të

një pjesë të futbollistëve. Në këtë moment e rëndësishme është të lëmë pas fjalët e hamendësimit dhe të jemi të gjithë bashkë për qëllimin kryesor, që është fitorja. Jam gjithmonë i qetë, sepse realisht klubi më ka qëndruar në krah dhe më ka mbështetur në çdo hap që kam hedhur. Por realisht, ndjehem unë i pari i zhgënjyer nga rezultate që unë i pari nuk i mendoja", deklaroi Duro.

Tekniku bardheblu ka përjashtuar anglezin, ndërsa do t'i duhet të bëjë edhe pa Blazhevskin në ndeshjen ndaj Kamzës

Jeton Selimi

Ardian Mema nuk ka ndërmend të tolerojë asnjë sjellje të gabuar të lojtarëve të tij, ndërsa duket se ka marrë vendimin ekstrem ndaj Majkëll Ngoos, anglezit të cili trajneri i ka bërë dajle për shkak të sjelljes së tij, ndërsa duket se nuk ka ndërmend të bëjë pas. E gjithë kjo situatë vjen në ndeshjen delicate kundër Kamzës, ku Tirana është e dëshpëruar për fitore, pasi humbja do ta zhyste më shumë në krizë me kamzalinjtë që do të parakalonin bardheblutë në renditje.

Te Tirana ka një çështje "Ngoo". A ka marrë klubi ndonjë vendim?

Nuk jam i qartë si do të veproj me të. Nëse ka sjellje rrugaçerie, çdo lojtarë do të largohet jo vetëm Ngoo. Duhet të jenë të gjithë të disiplinuar brenda dhe jashtë fushe. Unë kam rregullat e mia si trajner, nuk e di si vendos klubi, por për momentin ai nuk është më në planet e mia dhe besoj se nuk do të jetë.

Humbja kundër Flamuritit?

Në ndeshje po shkonte çdo gjë siç e kisha parashikuar, ekipi po luante në manovrën sulmuese. Do luhej drejt qendrës dhe do të ftoheshin edhe anësorët në lojë. Nuk kisha çfarë t'i thosha ekipit për mënyrën sesi luajt, por gabimet të ndëshkohen. Episodet dhe ndëshkimet të bëjnë të humbësh. Në raste të tilla kundërshtarët të shënojnë. Nëse vazhdojmë kështu më jep shpresë për takimin e radhës.

Ndaj Kamzës keni mungesa në sulm.

Sapo mbërrita këtu u dëmtuan Blazhevski dhe Kërçiku. Mungesat na i shojnë më shumë problemet do të luajmë ndryshe nga ndeshja e fundit. Do të luajmë ndryshe, por nuk mund të them më shumë për monovrat sulmuese dhe mbrojtëse.

Atëherë paraqitet e vështirë për ju.

Jemi të limituar në lojtarë pasi kemi të dëmtuar. Do të jetë një ndeshje e vështirë, do ta trajtojmë me video, kemi diskutuar edhe lojtarët, por nuk mendojmë

Ardian Mema: Ngoo një rrugaç, nuk toleroj sjellje të tilla

Trajneri ka probleme të mëdha me dëmtimet



rezultat tjetër përveç fitores. Do të tentojmë në çdo mënyrë për të dalë me 3 pikë. Unë nuk e besoj që ata kanë 5 mungesa, nuk është e vërtetë. Ekipin nuk e përgatis të luajë kundër të rinjve, por kundër më të mirëve.

Parë këto probleme, si do të luani të shtunën?

Kjo është një lojë me gabime, por nuk do të thotë se po gabove del nga formacioni. Unë nuk kam ardhur

këtu të mësoj lojtarët të luajnë futboll, por të shoh se kush është gati të luajë. Në analizë u thashë që secili ka përgjegjësitë e veta, por të parat kam unë si trajner. Nuk jam këtu për të ndëshkuar. Për sjelljen jo, por në fushë është gjë tjetër. Bluzën duhet ta fitosh, sepse nuk ta fal. Nuk jam këtu të plotësoj tekat e njërit apo tjetrit, kush është i gatshëm do të luajë. Edhe mua nuk ma ka

dhënë askush bluzën, e kam fituar. Jemi të limituar me lojtarë, kemi 18 futbollistë. Nuk e mendoj humbjen.

Por mund të mbështeteni te lojtarët e rinj si Muçi?

Klubi ka lojtarë të perspektivës. Një klub bazohet te lojtarët me eksperiencë dhe te disa të rinj. Kështu bëhet gërshetimi, edhe në kohën kur unë isha ende futbollist. Muçi është lojtar shumë i mirë, por momenti nuk është

SUPERLIGA		
Java e 10-të		
Të shtunën		
Kamza - Tirana		14:00
Flamurtari - Teuta		17:00
Të dielën		
Kastrioti - Luftëtari		14:00
Laçi - Kukësi		14:00
Të hënën		
Partizani - Skënderbeu		19:00
Renditja		
Skuadra	N	F
Partizani	9	22
Skënderbeu	9	20
Laçi	9	16
Kukësi	9	16
Teuta	9	14
Flamurtari	8	11
Tirana	8	8
Kamza	9	7
Luftëtari	9	6
Kastrioti	9	4

LOPETEGUI



Konte ndahet nga Çelsi, gati të marrë Realin e Madridit

Antonio Conte do të jetë i lirë të marrë përsipër stolin Real Madrid për sa i përket çfarëdo detyrimi kontraktual me Çelsin, raporton "Sky Sport". Kontrata e trajnerit italian me klubin e Londrës nuk do e pengojë Konten të drejtojë ekipin jashtë Anglie, por e ka të ndaluar të marrë stolin e skuadrave të Premier Ligës, deri sa kontrata t'i përfundojë. Conte u shkarkua nga Çelsi dhe u zëvendësua nga Maurizio Sarri në verë. Ai është kontaktuar nga përfaqësuesit e presidentit të Real Madrid, Florentino Perez, lidhur me disponueshmërinë e tij për të marrë kreun e pankinës. Lopetegui është nën presion në "Bernabeu" pas një fillim sezoni zhgënjës, i cili ka vetëm një fitore të vetme në gjashtë ndeshjet e fundit.

ZHVILLIME NË SHTËPINË ZIKALTËR


Steven Zhang është zyrtarisht president i Interit nga dita e djeshme, rol të cilin deri më tani e ka mbajtur Erik Tohir megjithëse gëzonte një përqindje më të vogël të aksioneve (31%). Prej ditësh, ishte njoftuar se në vijim do të vinte zyrtarizimi, ndërkohë që vetëm dje u hodh e zeza mbi të bardhë. Së bashku me presidentin, Zhang do

Zheng është presidenti i ri i Interit, pritet Marota

të blejë nga Tohir edhe 31% të aksioneve që ai kishte, duke e larguar përfundimisht indonezianin nga zikaltërit. Zhag bëhet në këtë mënyrë, presidenti i 21-të në historinë e Interit. Së bashku me Zhang, pritet të arrihet të zyrtarizohet edhe Bepe Marota, për të

cilin mediat italian raportojnë se gjithçka është mbyllur natën e kaluar dhe praktikisht, Marota do të jetë drejtor ekzekutiv te Interi. Ai do të jetë si krahu i djathtë i Zhang, ndërkohë që do të ketë edhe mbështetjen e Auslios e Antonellos.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Henri që qe piktor.
- Janë si kështjella.
- Maiden që këndojnë.
- Janë enë benzine.
- Është melodramë.
- Është vegël.
- Gjysmë sterile.
- Janë mallkime shkishëruese.
- Ishte zogu simbol i Jezu Krishtit.
- Ai dhe ajo.
- Janë sëmndjet që përhapen.
- Gjëja e romakëve.
- Shenjtorja që iu pre koka.
- Camus që shkroi I huaji.
- Fillojnë ilustrimet.
- Dieta pa ekstreme.
- Ndërmarrje Autonome Sarandë.
- Mund të jenë postare.
- Ekstreme në sirtar.

- I mungon asaj që i ka kaluar koha.
- Një ekip... anglez.
- Ente Ekonomike Rajonale.
- Një llahatar.
- Transporton edhe maune në det.
- Quinn aktor.

VERTIKAL

- Fillojnë mirë.
- Nuk i tregohën babait.
- Në hyrje të tokës.
- Gruaja e dytë e Atamantit.
- Merren në bllok.
- Kalimi në kufij.
- Qe burri i parë.
- Frolich e Marlene Dietrich.
- Kanë aderuar në parti.
- Shteti pa shi.
- Një pjesë e etiketës.
- Një pëllg.
- Janë kundërshtarë në gjyq.

- Është pije e jona.
- Luhën me 1. X, 2
- Mbrëtëria e Pirros.
- Braktisi Didonën.
- Emri tjetër i Esaut.
- Një pjesë e territorit.
- Një copë për xhepa.
- Janë patriotë të Chopin.
- Ray aktor.
- Mund të jetë solemn
- Alessandro, bomber të Juventus.
- Ylli i Londrës
- Sapo fillojnë
- Emri i Mondrian.
- Kufizojnë katete.
- Lindi Isakun.
- Thurman aktore.
- Në mes të Tommy dhe Jones aktor
- Harris aktor.
- Një rajon kur s'është ajo.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Gardner që qe aktore.
- Në krye të bashkisë .
- Emër vajze.
- Fillojnë pushimet.
- Janë si biskota
- Të fundit në ditat.
- Janë trupa pa kënde.
- Fillojnë notimin.
- Në radhë të parë.
- Pak latinisht.
- Është gjendje të fikti.
- Është vërtet e mërziqshme.
- Një mund të jetë fetar
- Gjysma e sallës.
- Pak dorështrënguar.
- Rastisin në krye.
- Një... dollar.
- Një pjesë e etiketës.
- Skuadra e Moratti-t.

VERTIKAL


- Një thirrje me emra.
- Vulosen të parat
- Këndojnë me zë të trashë të tillë
- Një mund të jetë armë.
- Mbyllin fushatat
- Një grimcë me bërthamë.
- Dacia shkrintare
- Është lloj papagalli
- Fillojnë afrimin.
- Kapet një me fishkëllimë.
- Mbahet në mbledhje.
- Ekberg aktore.
- Janë zburime.
- Janë dijetantë
- Janë zonat e kufizuara
- Janë tallësit.
- Fillojnë temën
- Një gjë.
- Bëhen për të mirë
- Është shtet aziatik.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Shkruhet në janar.
- Teliti regjisor.
- Një pjesë e dramës.
- Raset pa set.
- Inicialet e Penn aktor.
- Të fundit në studim.
- Kufijtë e rritjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4		9				7			5
	2	1		3		4	6		
2			1		3				9
		5				1			
3			7		5				6
	7	2		6		3	9		
1		3				8			4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar



7	4	9	5	6	1	3	8	2
8	2	5	3	7	4	1	9	6
6	1	3	8	9	2	7	4	5
1	7	4	6	2	5	8	3	9
9	8	6	7	1	3	2	5	4
3	5	2	9	4	8	6	1	7
5	3	7	2	8	9	4	6	1
2	9	1	4	3	6	5	7	8
4	6	8	1	5	7	9	2	3

Argëtim filozofik

- Ajo që nuk më vret më bën më të fortë (Friedrich Nietzsche)
- Hitleri dhe Mussolini ishin vetëm zëdhënësit e qëndrimit mbi dominimit dhe dëshirës për pushtet që janë pothuajse në zemrat e të gjithëve. Derisa burimi të pastrohet, gjithnjë do të ketë konfuzion dhe urrejtje, luftëra dhe antagonizma klasorë (Jiddu Krishnamurti)
- Nuk mund të shkelësh dy herë në të njëjtin lumë (Herakliti)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

R	E	S	H	A	T	M	I	S	T	E	R	E
P	R	A	P	E	S	I	T	U	D	O	R	
M	I	T	U	R	A	N	D	O	T	M	O	
A	R	M	A	N	D	A	L	E	S	A	T	
R	O	F	E	D	E	R	A	L	E	I		
S	T	D	E	K	O	R	A	T	A	D	K	
H	E	R	E	T	I	K	E	A	A	E		
I	E	T	A	P	A	I	P	A	L	M		
M	C	L	A	R	E	N	P	O	S	T	A	R
I	A	R	E	T	S	I	R	T	A	R	I	
N	D	E	A	M	A	T	O	R	E	T		
K	A	M	S	E	R	A	P	E	N	E	T	
C	A	P	O	N	E	K	S	K	A	F	I	
O	D	I	N	I	P	O	R	R	R	V		
R	A	S	A	B	I	M	E	S	I	A		
R	K	M	I	L	I	M	E	T	R	I		
I	T	M	O	N	O	T	O	N	I	A		
D	E	L	T	A	R	E	T	A	K	T	E	
A	N	E	T	A	R	E	T	E	N	T		
Q	O	S	E	T	B	O	U	Z	O			
P	D	M	I	T	P	I	R	A	T	I		
L	O	H	A	N	Z	E	M	E	R	I		
A	R	E	N	A	T	E	T	E	A	R		
K	A	P	I	T	A	L	E	T	S	I	T	A

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Nuk ka njeri, sado i zgjuar, që në një periudhë kohore të rinisë së tij të ketë thënë gjëra, ose të ketë jetuar në një mënyrë që ndërgjegjes së tij të tashme mos t'i pëlqejnë më (Marcel Proust)
- Nëse s'mund të fluturosh, vrapo, nëse s'mund të vraposh, ec, nëse nuk ecën, kacavjerru, por si do që të jetë, vazhdo të ecësh përpara (Martin Luther King)

